

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7468 E mërkurë 14 Mars 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Deutsche Welle"
Si shumë grekë të tjerë edhe Nikos Varthimiadis falimentoi. Borxhet e mëdha ia shkatërruan vitin e kaluar furrën e bukës dhe e detyruan këtë mesoburrë, baba ...
Vijon në faqen 20

Nga ANTHE CARASAVA
Greqi, nga afendikonj, në punëtorë krahu


Opinion i Ditës
Është një lutje, letër e hapur apo tërheqje vemendjeje për tre zotërinjtë që kanë qenë shumë aktivë në ruajtje të monumenteve të së shkuarës, por ...
Vijon në faqen 21

Nga DRITAN HILA
Një kërkesë Artan Lames, Artan Shkrelit dhe Auron Tares



Viktima Lirije Lami

E rrallë/ Vjehri e dinte, por nuk foli
21-vjeçarja helmoi vjehrrën, u rrëfyte te hoxha: Zoti të më falë mëkatin

Marjana Cmeta arrestohet një vit pas krimit.
Hoxha e regjistroi dhe videon ia dha familjes

Nga DORJANA BEZAT

Mosmarrëveshjet e shpeshta mes 21-vjeçares Marjana Cmeta dhe vjehrrës së saj, Lirije Lami duket se kanë çuar në krimin e rëndë brenda familjes të ndodhur në prill të vitit të kaluar në Kamëz. Marjana Cmeta është ...
Në faqen 7

QEVERIA PEZULLON NJOHJEN E PRONESISE NE DURRES, VLORE DHE SHKODER

"NGRIN" DHENIA E TAPIVE NE 12 BASHKI NE BREGDET

Vendimi i ri, qeveria u jep prioritet investimeve strategjike, bllokohet procedura e kalimit në pronësi të tokave bujqësore të ish-ndërmarrjeve shtetërore



(Në foto) Toka në bregdet

PREMTIMI

Rama: Rruga Tiranë-Elbasan do të përfundojë brenda vitit

Në faqen 3

KRYETARJA E LSI

Kryemadhi: Lufta më e madhe, kundër varfërisë. Rusët me PD? Qesharake

Në faqen 2

EMRAT E PERFITUESVE

Dosjet e vitit '95, lista e dytë me pronarët që do kompensohen

Në faqen 10-11

"VIP PAGES"

Alketa Vejsiu zbulon krahun e djathtë të saj te "Piter Pani"

Suplement

AEIITA MANI: ORIENTIM DREJT RRUGES SË LIDERIT



Studentët e "Luarasit", leksion i hapur me 2 ekspertë të huaj
Në faqen 9

Neritan Liçaj: Kryeministri na kërcënoi. Arben Derhemi: Ne, armiqtë e klasës

Artistët: Teatri Kombëtar, projekt korean

Genc Fuga: A do ta dorëzoj taserën e PS? Të mbarojë lufta e idealit...

Nga FATMIRA NIKOLLI

Projekti i arkitektit danez Bjarke Ingels për Teatrin e ri Kombëtar, prezantuar të hënën në kryeministri, ka hasur në kundërshtimet e komunitetit artistik. Uniteti i fillimshkurtyt, i ka lënë vendin përçarjes



mbi të ardhmen e godinës ekzistuese dhe nevojës për një teatër me kushte. Të hënën, mes shumë artistëve të pranishëm në Kryeministri, vetëm Robert Ndrenika pati guximin të fliste hapur, publikisht kundër projektit që parasheh një godinë ...
Në faqen 18-19

OPOZITA
LSI

Darina Tanushi

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi cilësoi si betejën më të madhe të partisë që drejt luftën ndaj varfërisë. Gjatë një bashkëbisedimi me gazetarët, Kryemadhi tha: "LSI propozon të rikthehet edhe njëherë në parlament ligji për taksat, sepse kjo nuk është më një çështje egoje personale e Edi Ramës dhe asnjë fjalë e dhënë ndaj oligarkëve shqiptarë, por është çështja e mbijetesës së qindra dhe mijëra bizneseve shqiptare, që taksat e larta jo vetëm i varfërojnë, por i çojnë drejt shpërbërjes". Sipas saj, vetëm në 2 muaj 2500 biznes kanë bërë kërkesë për t'u mbyllur. Nuk munguan në deklaratën e Kryemadhit as batutat me "çizmen", "Raporti i BERZH na paralajmëron që pas 60 viteve ne do të kemi shansin të kemi ritme mesatare me BE. Pra, kur unë të jem 104 vjeçe, ne do të jemi pothuajse si europianët dhe jam e bindur që stërnipërit e mi do më thonë t'u thaftë dora që ajo çizma jote nuk i ra në kokë Edi Ramës që ta shkundte pak nga trutë dhe të bënte diçka të mirë për këtë vend. Dhe breza të tërë gjatë këtyre 60 viteve do të largohen nga Shqipëria dhe nuk do ta kthejnë më kokën pas duke parë ritmet me të cilat po zhvillohet ky vend", tha ajo. "Opozita dhe kryesisht LSI ia kanë krijuar qeverisë të gjitha kushtet me një komoditet të jashtëzakonshëm për negociatat, sepse mendojmë që negociatat janë shumë më të rëndësishme se axhenda politike e partive politike", u shpreh Kryemadhi, e cila tha se i kishte dërguar një letër komisionerit të Zgjerimit, Johann Hahn, ku shpreh mbështetjen e LSI-së për hapjen e negociatave.

BASHKËPUNIMI ME PS

Duke komentuar mungesën e saj në media, Kryemadhi tha: "Më mirë të kenë mall për mua sesa të kenë mall socialistët që të kërcasë ndonjë çizme tjetër, se me situatën që ka ardhur vetëm çizmet që nuk dalin". Kryemadhi la të kuptohet se bashkëpunimi me PS-në do të ketë në interes të qytetarëve të vendit. "Marrëdhëniet e mia qoftë me Z.Basha, edhe me z.Rama personale janë marrëdhënieshëm të mira. Me z.Basha aktualisht jemi në marrëdhënieshëm bashkëpunimi për sa i përket frontit opozitar: Përsa i përket bashkëpunimit politik, në 27 vite tranzicioni nuk jemi mësuar që t'i shikojmë partitë e opozitës që të jenë të hapura për të ofruar zgjidhje dhe alterna-

Kryetarja e LSI: Nipërit do thonë "t'u thaftë dora që nuk i re Ramës"

Vendoret 2019, Kryemadhi: Mund të kemi kandidatë të përbashkët me PD

"Akuzat për lobin rus ndaj Bashës, qesharake"



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi

KANDIDATËT

LSI do të shpallë fushatën e përzgjedhjes së kandidatëve të saj për zgjedhjet lokale, qoftë për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiakë, edhe për kandidatët për kryetarë bashkie aty ku LSI pretendon që të ketë fituesit e saj.

Vasili: Flitet për skenarë rusë, shantazhe ruse

Kreu i grupit të LSI sulmon Ramën: Idiot e hajdut i certifikuar në krye të qeverisë

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili akuzoi sërish dje kryeministrin Edi Rama, ndërsa e quajti atë një "idiot dhe hajdut i certifikuar". Përmes një mesazhi në faqen e tij të "Facebook", Vasili kujton veprën e Dostojevskit "Idioti". Ky reagim vjen pas akuzave që mazhoranca dhe vetë kryeministri kanë lëshuar drejt kreut të Partisë Demokratike për lobime me rusët. "Idiot dhe hajdut i certifikuar. Flitet për skenarë rusë, shantazhe ruse, nderhyrje ruse.




Një rus i madh. Dostojevski, ka shkruar një kryevepër 'Idioti', por të një idioti

të dobishëm. Kemi edhe në një idiot, por tërësisht të padobishëm, e kemi edhe në krye të qeverisë. Kërshërinë që ta marrim vesh se është idiot na e shoi vite më parë Mero Baze, një profesionist i njohur i gazetarisë, që në shërbim të transparencës publikoi edhe kartelën e tij mjekësore. Por ju mos ia përmendni idiotët në se këtë alibi do ai, që të thonë 'vjedh se është idiot dhe nuk kupton'. Por në fund prapë se prapë mbetet idiot dhe hajdut i certifikuar", u shpreh z. Vasili.

tiva", tha ajo. "Unë dua të them që historia e bashkëpunimeve 'underground' në LSI nuk do ekzistojë. E them këtë sepse bashkëpunimet do jenë transparente. Bashkëpunimet 'underground' janë bashkëpunime që prodhojnë kriza, destabilitet, varfëri dhe prodhojnë pushtet për oligarkët", tha Kryemadhi. Sa i përket ndonjë bashkëpunimi me PS-në në

zgjedhjet vendore, ajo tha se vendimi u përket strukturave dhe në këto zgjedhje janë individët që do të gërojnë jo partitë. Ndërsa sa u përket kandidatëve të përbashkët me PD-në, Kryemadhi tha se mundet të kenë. E pyetur në lidhje me akuzat e bëra ndaj kreut të PD-së, Lulzim Basha për financimet ruse, Kryemadhi tha: "Mua më duken shumë qesharake.

Problemi sot më i madh nuk është se a ka bërë fotografi me Presidentin Trump Lulzim Basha, apo ka paguar Partia Demokratike nga fondi apo buxheti i saj për lobing në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Besoj që e mbani mend që Edi Rama veshi fustan për të bërë një fotografi me Obamën para disa viteve dhe nuk ishte kjo gjë më kaq e madhe".



Kryeministri Edi Rama, dje gjatë mbledhjes së qeverisë, organizuar në qytetin e Elbasanit

DEKLARATA

"Personi të cilit i intereson më shumë moshapja e negociatave është Edi Rama, sepse hapja e negociatave e vendos brenda një kuadrati ligjor dhe rregullash, të cilat ai nuk i ka me shumë dëshirë t'i zbatojë. Hapja e negociatave janë kushte, hapja e negociatave janë detyrime që duhet t'i bëjë qeveria shqiptare dhe jo opozita", tha Kryemadhi.



Reagojnë të larguarit: S'na lidhte gjë me PD-LSI

Gjirokastrë, 4 këshilltarë nga LSI e PDIU i bashkohen PS-së

Pasi një këshilltar i LSI dhe një PDIU-së kishin deklaruar se i ishin bashkuar Partisë Socialiste në Këshillin Bashkiak të Gjirokastrës më 2 mars, duket se tashmë edhe një tjetër këshilltar i LSI-së ka ndjekur veprimin e tyre. Në fakt, Adrian Hyskë nga LSI dhe Selaudin Moshos nga PDIU i është bashkuar edhe Arben Rexhaj po nga radhët e LSI-së. Në një reagim të tyrin gjatë ditës së sotme, anëtarët e këshillit bashkiak janë shprehur se janë zgjedhur nga populli dhe jo nga krerët e partive, ndaj është e drejta e tyre që të zgjedhin forcën politike që vërtet i lë hapësirë për të dhënë kontributin e tyre. Dy këshilltarët kanë hedhur akuzat edhe ndaj PD, duke theksuar se më këtë forcë politike nuk ka asgjë çfarë e bashkon, pasi ndaj PD tashmë rëndon edhe një fakt i rëndë, se me financime okulte ruse ka tentuar të krijojë trazira dhe të dëmtojë Shqipërinë. "Me aleancën PD-LSI nuk kishte më asgjë çfarë na bashkonte, aq më tepër kur sot jemi përpara një fakti të rëndë. Partia që para 27 vitesh lindi si shprehës për shqiptarët, sot merr financime okulte nga oligarkët rusë, vetëm e vetëm për të nxirë Shqipërinë dhe për të krijuar trazira. Besoj se kjo turpëron edhe kolegët e tjerë demokratë në Këshillin Bashkiak të Gjirokastrës dhe të gjithë mbështetësit e PD-së. Lulzim Basha duhet të shkojë përpara drejtësisë për këtë aferë të rëndë kundër Shqipërisë, ndërsa LSI-ja mund të vazhdojë t'i qëndrojë nga pas duke rikonfirmuar se ka qenë dhe mbetet parti tepsie dhe që s'i intereson asgjë tjetër veç pushtetit", thau në qëndrimin e tyre para opinionit publik këshilltarët.



Kryeministri: Rruga Tiranë-Elbasan marrëzi e së shkuarës, mbaron brenda vitit

Edi Rama me qytetarët në Elbasan: Të dënojmë grabitqarët në zyrat e shtetit

Pensionet e emigrantëve, Bushati: Do gjejmë zgjidhje me Greqinë

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama premtoi dje, përfundimin e rrugës Tiranë-Elbasan brenda vitit. Pas mbledhjes së qeverisë, organizuar në qytetin e Elbasanit, Rama tha: "Ende nuk i kemi mbushur dot plotësisht, qoftë për arsye të marrëzive të së shkuarës, qoftë për arsye të shfaqjes së babëzisë të së shkuarës së afërt. Kam parasysh rrugën Elbasan-Tiranë, kam parasysh edhe rrugën tjetër, Qukës-Qafë Ploçë. Projekte skandaloze. Kontrata skandaloze. Menaxhim skandaloz. Rritje kostosh skandaloze". "Siduqoftë, ajo çka ne jemi angazhuar dhe jemi të vendosur të realizojmë, është që rruga më në fund të finalizohet brenda këtij viti, pra, të hapet përfundimisht dhe të lidhet përfundimisht, përmes kësaj rruge të re, Elbasani me Tiranën. Nderkohë do të ecet më tutje me segmentin Qukës-Qafë Ploçë, që lidh Elbasanin me Korçën", sqaroi Rama. Po ashtu ai bëri të ditur se është diskutuar edhe për projektin e transformimit të zonës së ish-Metalurgjikut. Më pas, gjatë një takimi që pati me qytetarët të Elbasanit, u bëri thirrje të aplikojnë në platformën e bashkëqeverisjes, si një mënyrë jo vetëm për zgjidhur problemet me administratën, por për të qenë pjesë e qeverisjes njësoj si të jenë deputetë. Rama në fjalën e tij u shpreh se janë 5 mijë ankesa të regjistruar në këtë fazë fillestare. Ai tha se problemet janë të mbartura në kohë dhe janë duke u zgjidhur. "Ju nevojiten vetëm tre minuta për t'u regjistruar asnjë më shumë dhe brenda 10 ditëve merrni përgjigje", tha Rama. "Para se sa të them disa fjalë në lidhje me platformën dhe pse është shumë e rëndësishme që të dimë se gjithkush të dijë se kush ka problem me administratën të mos dorëzohet, por të ndërhyjë nëpërmjet platformës së bashkëqeverisjes. "Cdo qytetarë mund të jetë pjesë e qeverisjes dhe duke qenë pjesë e këtij portali, është si të jetë një deputet, dhe me problemën e tij kujdeset menjëherë ministri apo ministria. Në këtë mënyrë, grabitqari, grabitësi, që është zyrtari që s'ka zgjidhur hallin e qytetarit dhe s'ka ku shkon më", u shpreh Rama. "Deri më sot që platforma ka nisur të jetë efektive dhe që është në fazën fillestare janë mbi 5 mijë raste. Ajo që është



Kryeministri Edi Rama

DITMIR BUSHATI

Ministri i Punëve të Jashtme, Ditmir Bushati, gjatë fjalës përpara banorëve të qarkut të Elbasanit u shpreh se çështja e pensioneve të emigrantëve që ndodhen në Greqi nuk është një problem me karakter politik, por më tepër është një problem financiar. "Me Kanadanë kemi ecur përpara, ndërsa me Italinë dhe Greqinë po punohet", - tha ai.

ERJON BRAÇE

Deputeti socialist, njëherësh kryetar i Komisionit të Ekonomisë, Erjon Braçe ka kërkuar logarit nga qeveria, përse ka vendosur të shkurtojë në Kashar, aksin rrugor Thumanë-Rrogzhinë. "A ka njeri nga qeveria ime të më thotë përse aksi Thumanë-Rrogzhinë duhet të shkurtohet në Kashar?", pyeti dje Braçe, duke thënë se kjo nuk vlen pasi nuk arrin në Rrogzhinë, siç ka qenë ideja fillestare në vitin 2004.

DAMIAN GJIKNURI

Gjatë takimit një prej banorëve ngriti problemën e rrugës Tiranë-Elbasan dhe Rama i tha Gjicknurit se kjo është një sfidë për të, ose të mbarojë rrugën, ose të mbarojë për vete. Ndërsa Gjicknuri tha: "Unë e kam marrë përsipër, pres lëvrimin e fondit dhe barra do kalohet së bashku me kryeministrin".



Spiropali: Basha të mos i shmanget drejtësisë duke përdorur mandatin

Lulzim Basha nuk mund t'i shmanget më drejtësisë, duke e përdorur mandatin e deputetit opozitar, siç përdori dikur një raport mjekësor, por të dalë të thotë të vërtetën", deklaroi dje, në një dalje për mediat Elisa Spiropali, Sekretare për ririnë dhe koordinatore kombëtare për bashkëqeverisjen në PS. Sipas saj, "ka mbi një javë që çdo ditë, jo në mediat komuniste të Amerikës si "New York Times" por në median shqiptare, dalin fakte të reja. Por Lulzim Basha nuk arrin dot të japë as edhe një përgjigje të saktë për një krim financiar në aktivitetin elektoral e ndërkombëtar të Partisë Demokratike, që po bëhet gjithmonë e më i madh". "Basha deklaroi se i ka dhënë kompanisë së lobimit vetëm 25 mijë dollarë, kurse kompania e lobimit deklaroi se ka marrë 675 mijë dollarë për punën që ka bërë për Bashën. Këto deklarime, të cilat Basha i quan sajesa, nuk i ka bërë dikush që me Bashën nuk ka asnjë lidhje; nuk i kanë bërë as mediat komuniste amerikane dhe as mediat shqiptare; i ka bërë vetë i punësuar i Lulzim Bashës, Nick Muzin", tha Spiropali. Prandaj, shtoi Spiropali, s'ka asnjë dyshim se ai që gënjen nuk mund të jetë kurrikush tjetër veçse Lulzim Basha, të palartë e të cilit i ka nxjerrë në shesh kompania e lobimit me të cilën Lulzim Basha ka marrëdhënie kontraktuale të bëra jo në kafene, por me deklaratat financiare tashmë të depozituara pranë Departamentit Amerikan të Drejtësisë dhe Njësisë së Regjistrimit të Agjentëve të Huaj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Për këtë arsye uluritë, Lulzim Basha duhet të përgjigjet përpara ligjit, qoftë për gjysmë milionë dollarët ekstra që Partia Demokratike i ka paguar kompanisë së lobimit, qoftë për dhuratën ruse prej 150 mijë dollarësh që kompania e lobimit Muzin ka marrë nga firma Biniatta në këmbim të punës që Muzin ka kryer për Bashën", -tha ajo.

dramatike është fakti që rastet janë skandaloze, pasi këto raste janë me vete. Por janë zgjidhur me një kohë rekord". Nga ana e tij, kreu i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla tha se gjatë viteve të fundit janë investuar rreth 500 milionë euro në infrastrukturë. Sipas Ballës, objektivi mbetet kthimi i Metalurgjikut në një burim të ardhurash dhe zhvillimi për rajonin, teksa nënvizoi se turizmi dhe

agrobujqësia janë baza kryesore. Pas shtetësimeve të shprehura nga ana e qytetarëve të ndryshëm, fjalën në takim e mori edhe ministri i Jashtëm Ditmir Bushati, i cili tha se emigrantët shqiptarë në Greqi përmes heqjes së vulës apostile po kursejnë rreth 6.7 milionë euro, si dhe kohë të vyer. "Ne kemi bërë disa përmirësime të dukshme se si ofrohen shërbimet në Itali dhe Greqi në veçanti, duke u për-

piekur për t'i ardhur në ndihmë bashkëatdhetarëve tanë, që jetojnë në Itali e Greqi. Me Italinë kemi bërë shumë progres, jo vetëm për shërbimet online, por dhe me disa shërbime, siç është dhe rasti i certifikatave që mund të merren pa ardhur në Shqipëri. Pala Greke nga krahu tjetër ka hequr vulën apostile, duke u kursyer bashkëatdhetarëve tanë kohë dhe rreth 6 milionë euro në vit", -tha Bushati.

'Lobimi rus', deputetët e PS dhe PD shkëmbejnë batuta në komision

Hysenaj i PS: "Binata Trade" del takim me vajzat ukrainase. Bylykbashi: T'i bjerë Ulsiu

Deputetët e Komisionit parlamentar të Ligjeve shkëmbejnë dje, batuta duke marrë shkas nga çështja e shumë diskutuar ditët e fundit për përshirjen e PD-së në financimet ruse për lobim në SHBA. Debatet mes anëtarëve të komisionit të ligjeve janë bërë në prani të Besnik Dervishit, Komisionerit për të Drejtën e Informimit. Deputeti Alket Hysenaj ka kërkuar të dijë nëse ka informacion për lidhjet e PD-së me Nik Muzin dhe Binata Trade, pasi sipas tij, numri i kontaktit i kësaj kompanie rezultoi një klub në Ukrainë. Kaq mjaftoi që në mbledhje



të plasnin batutat.

Alket Hysenaj: Keni informacion për lidhjet e Partisë Demokratike me Nik Muzin dhe Binata Trade. Nga numri i kontaktit i kësaj kompanie, del një klub në Ukrainë. TOO LOVE Club.

Takime me vajza ukrainase.

Enkelejd Alibeaj: I paske rënë numrit për takime me vajza nga Ukraina.

Hyseni: Çfarë mund të na thoni për këto lidhje mes PD dhe biznesmenëve rus.. Dhe klubeve të natës. Takime me vajzat ukrainase.

Oerd Bylykbashi: I paske rënë disa herë numrit të ukrainaseve.. Jepia edhe Ulsiu.. T'i bjerë dhe Ulsiu.

Ulsi Manja: Zoti Dervishi, jepni një përgjigje, sepse kjo është një çështje që ka direkt lidhje me të drejtën e informimit.

LOBIMI I PD DEBATI

Valentina Madani

Ambasadori i SHBA-së Donald Lu takoi dje kryetarin e PD-së Lulzim Basha për ecurinë e reformës në drejtësi. Takimi zgjati rreth 70 minuta në selinë e demokratëve dhe është kërkuar nga ambasadori amerikan në Tiranë. Burime pran PD bëjnë të ditur se kreu i PD, Basha dhe ambasadori Lu shkëmbyen pikëpamje mbi zbatimin e reformës në drejtësi, luftën kundër krimit dhe drogës dhe proceset e ardhshme politike brenda Partisë Demokratike. Ditët e fundit opozita e maxhoranca po sulmojnë njëra-tjetrën me akuzat të ashpër. Maxhoranca kërkon hetim pas investigimit të revistës amerikane sipas së cilës PD ishte financuar nga rusët. Nga ana tjetër, PD shprehet se qeveria fshihet pas garancisë së ngarkesës prej 613 kg kokainë dhe kërkon të fshihet këtë fakt duke sulmuar opozitën.

KËRKESA

Partia Demokratike i kërkon kryeministrit transparencë, për ato që i quan lidhje me Rusinë. Nga selia blu, deputetja Oriola Pampuri, i ka kërkuar shefit të qeverisë, të zbardhë takimin që vetë pranoi, me pronarin e një biznesi rus, në listën e zezë të SHBA. Deputetja e PD-së Orjola Pampuri në një deklaratë për mediat sulmoi kryeministrin Edi Rama se ky i fundit kishte pranuar publikisht që ishte takuar me kompani ruse që rezultojnë në listën e zezë të SHBA. Në emër të PD-së Pampuri pyeti Ramën se kush i solli rusët e 'Gunvor' në zyrën e tij në Tiranë? ndërsa shtoi se 'Çfarë marrëveshje ka bërë Edi Rama me Erdoganin për ndërtimin e aeroportit të Vlorës nga një kompani që ndërton centrale bërthamore me kompani shtetërore ruse?' "Edi Rama pranoi drejtpërdrejt në TV, se ai është takuar me kompani ruse në listën e zezë të SHBA. Por ai, qëllimisht e anashkaloi emrin e kompanisë dhe detajet. Edi Rama duhet të përgjigjet: 1. Kush i solli rusët e 'Gunvor'it në zyrën e tij në Tiranë? 2. Çfarë u diskutua dhe u ra dakord me ta? 3. A ka 'Gunvor' në Shqipëri një kompani të përbashkët me Besnik Sulajn, mikun e ngushtë të Edi Ramës? 4. Çfarë marrëveshje ka bërë Edi Rama me Erdoganin për ndërtimin e aeroportit të Vlorës nga një kompani që ndërton centrale bërthamore me kompani shtetërore ruse? Gjithashtu, Edi Rama duhet të përgjigjet: 1. Çfarë ka biseduar Damian Gjiknuri në

Kërkesa ndaj kryeministrit, për transparencë: Kush i solli rusët e me "Gunvor" në Tiranë

Kompania ruse e centraleve bërthamore, PD: Rama të zbardhë marrëveshjen

'Drejtësia', ambasadori Lu takon Bashën në zyrë



Ambasadori i SHBA-së, Donald Lu me kryetarin e PD-së, Lulzim Basha

EDI PALOKA

Deputeti i PD, Edi Paloka reagoi në "Facebook" ku shkruan se "Rama u përpoq së fundi të banalizojë akuzat mbi lidhjet e tij direkte me drogën". Sipas tij, kryeministri u përpoq të vendosë paralele me qytetet e Europës, por "nuk u shpjegoi shqiptarëve se asnjë nga ministrat e Brendshëm të atyre vendeve apo familjarët e tyre, ose familjarët e kryeministrit nuk janë kapur në përgjimit për lidhje direkte me trafikantët".

Kontratrat



ARBEN RISTANI

Sekretari i përgjithshëm i PD, Arben Ristani deklaroi se investigimi i "Mother Jones" është nxitur nga socialistët. Ristani është zyrtari përgjegjës për kontratat e PD-së. Akuzat e fundit të socialistëve për transparencë të financimit të aksionit 3-mujor të PD në çadër, për Ristanin janë taktikë për të tërhequr vëmendjen nga droga e krimi, pasi PD e ka transparent çdo akt.

Revolucion popullor për rrëzimin e qeverisë

Noka: Ramën e ndihmon 'Father' Soros nëpërmjet 'Mother Jones'

Deputeti i PD-së, Flaimur Noka, foli dje për akuzat e qeverisë ndaj PD për financimet ruse, pas artikullit të publikuar në revistën "Mother Jones". Noka tha se e gjithë kjo tymnajë bëhet për të mbuluar skandalet e qeverisë së tij. Sipas tij "Mother Jones" është një gazetë mbrapa së cilës fshihet babai shpirtëror i Edi Ramës, George Soros. "Edi Rama është mjeshër i tymnajave për të mbuluar skandalet e qeverisë së tij. Le të vijojnë hetimet. S'ka asgjë për të fshihur nga Partia Demokratike. "Mother Jones" është një gazetë mbrapa së cilës fshihet babai shpirtëror i Edi Ramës, George Soros. Që këtu kuptohet. Father Soros nëpërmjet "Mother Jones" i vjen në ndihmë



Edi Ramës që paguan për këtë gjë. Po pse ndodh kjo e pikërisht tani? Se skandalet ku është zhytur Rama janë të tilla sa në një vend normal do rrëzonim 10 qeveri. A ka fakt më të madh se të kafen 613 kg kokainë? E vërteta doli që Shqipëria është bërë Kolumbi e Europës, avionët iknin e vinin me drogë. Fjalët tona i citon departamenti amerikan i sh-

tetit. Është vendi i parë në botë për konsumimin e kokainës, pse nuk ishte kur drejtoja unë dhe qeveria Berisha. Peshku i madh është në familjen kryeministrale, duhet dështuar transporti se do dilte familja Rama", tha Noka në studion e News24. Lidhur me takimin e kreut Basha me ambasadorin Lu, deputeti i PD tha: "Për zhvillimet e fundit politike, skandalet e radhës së kësaj qeverie. Me skandalet të tilla një qeveri normale duhet të dorëzohet, nuk e kemi thënë kot ne. Ka vetëm një zgjidhje në këtë vend, revolucion për ta përjashtuar këtë qeveri. Me revolucion popullor: Opozita ka një synim, rrëzimin e klikes që është në pushtet dhe prandaj jemi bashkë dhe me LSI".

Shën Petërsburg me Robert Novikoshyn e Jurimexit, një personazh të cilësuar nga Senati Amerikan dhe Bashkimi Europian si person që rrezikon pavarësinë energjetike të Evropës?

2. Çfarë i është premtuar

Jurimexit?,- deklaroi zj.Pampuri. Sipas saj të gjitha nyjet e drogës, krimit, pastrimit të parave, ndikimeve të paligjshme përfundojnë tek Edi Rama dhe familja e tij. Ky realitet, shprehet ajo, nuk mund të fshihet dot

nga sulmet që i bëhen Partisë Demokratike, të paguara me paratë e kokainës dhe të krimit. "As vendosmëria e Partisë Demokratike kundër krimit dhe drogës nuk ka për të ndryshuar",-deklaroi deputetja e PD-së.



Ish-kryetari i KQZ-së, Çlirim Gjata

Lobimi i demokratëve në SHBA

Gjata: KQZ, jo pjesë në hetime, bëhet bisht i politikës

KQZ nuk duhet të jetë pjesë e çfarëdo hetimi për akuzat e mazhorancës në lidhje me përfshirjen e rusëve në lobimin e partisë Demokratike në Shtetet e Bashkuara. Konstitucionalisti dhe ish-kryetari i KQZ-së, Çlirim Gjata tha dje për Ora news se institucioni rrezikon të bëhet pjesë e politikës. Prioritet sipas Gjates, KQZ duhet t'i japë zbatim të ligjit për financimin e partive. "Problemi është që të mos bëhet bisht i politikës, pasi do ishte problem shumë i madh për KQZ-në. Kur mbaruan zgjedhjet ishte gjithë koha e mundshme, u caktuan financierët kontrollues, u bënë deklaratat, u bë transparencja, aq sa mund të bëhej me këtë ligj mbi kontrollin e financimit nëpër fushata. Çohet tani KQZ-ja dhe kërkon të gjejë se financat kanë qenë të paligjshme. Po gjeje përpara se aty e kishe ligjin! Zbato kriteret ligjore se s'mund të dalësh jashtë kriterëve ligjore. Këtu duhet të diskutohet mbi sistemin e kontrollit të financave të partive",-tha z.Gjata. Sipas tij imediate është ndërtimi i një strategjie për sistemin e kontrollit financiar të partive politike në fushata dhe jashtë tyre, pasi nëse financimi i partive kthehet në veçpër penale, atëherë do të prekeshin të gjitha partitë.

Thumanë-Kashar, qeveria miraton bonusin për "Gener 2"


Oferta për ndërtimin e rrugës së re, 244 milionë euro

Qeveria ka miratuar vendimin që i jep një bonus prej 8.5 pikësh kompanisë "Gener 2", lidhur me projektin e paraqitur si ofertë e pa kërkuar për ndërtimin e rrugës Thumanë-Fushë Krujë-Vorë-Kashar. I pari që ka dhënë lajmin ishte kryeministri Edi Rama përmes një statusi në rrjetet sociale ku shkruante se tashmë ishte hapur drita e gjelbër për projektin e dytë të paketës One Billion. "Qeveria i hap rrugën projektit të dytë të Programit 1 miliard për rindërtim, aksi Kashar - Thumanë, segment me rëndësi të posaçme për infrastrukturën rrugore të

Shqipërisë që duam. Ndërlidhje më e shpejtë dhe më e sigurt e Veriut me kryeqytetin" shkuan Rama. Miratimi i bonusit për "Gener 2" i hap rrugë tashmë procedurave normale të garës për ndërtimin e rrugës, por që normalisht falë ofertës së pa kërkuar ajo do të jetë e avantazhuar nga pikët. Projekti i propozuar për rrugën është ndërtim dhe mirëmbajtje. E gjithë kontrata parashikohet 10 vjet, ku dy vitet e

para janë ndërtim dhe 8 vite janë mirëmbajtje. Kostoja e ndërtimit parashikohet të jetë në vlerën 244 milionë euro. Ky shpenzim, parashikohet të kryhet në një kohëzgjatje 24 muajore. Kostot totale të projektit do të përfshijnë shpenzimet kapitale dhe mirëmbajtjen rutinë. Mirëmbajtja do të fillojë nga viti i tretë dhe do të zgjasë për 8 vite. Me qëllim minimizimit e ndikimit social negativ që autostrada e re mund

të sjellë, është parashikuar rehabilitimi i rrugëve, të cilat ndërpriten nga autostrada e re, të cilat ndahen në: rrugë kryesore, ku përfshihen: rrugë kryesore, rrugë dytësore. Projekti i autostradës Thumanë - Kashar përfshin ndërtimin e 12 urave. "Sipas propozimit të kompanisë rezulton se kjo mënyrë përmbush parimin e shpërndarjes efektive të riskut, duke e bërë këtë pro-



jekt të tipit koncesion/PPP të realizueshëm. Nga studimi i fizibilitetit rezulton se shoqëria "Gener 2" ka marrë përsipër pjesën më të madhe të risqeve. Veçanërisht në lidhje me fazën e mirëmbajtjes dhe operimit, risku i

disponueshmërisë së veprës, i cili ka të bëjë me ofrimin e një aseti sipas cilësisë dhe standardit të kërkuar dhe që përmbush në mënyrë cilësore nevojat e përdoruesve, merret përsipër nga pala private.

Pezullohen procedurat e kalimit në pronësi në Shkodër, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Vlorë, Himarë, Sarandë etj.

Qeveria "ngrin" ligjin 7501 për tokat në bregdet

Nuk ka tapi, u jepet prioritet investimeve strategjike

Qeveria pezullon përkohësisht njohtjen e të drejtës mbipronën për ata që përfituan tokë bujqësore nga ligji. Bëhet fjalë për peronat që kanë përfituar tokë nga ish-ndërmarrjet shtetërore që në vitin 1991. Këshilli i Ministrave vendosi pezullimin e përkohshëm të procedurave të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe të regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi, në zonën me rëndësi për fondin e mbështetjes së investimeve strategjike. Në listë janë qytete: Shkodër, Lezhë, Kurbin, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Konispol.



Foto ilustruese

hartën e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të pezullojnë procedurat e kalimit në pronësi të tokës së ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe të regjistrimit të akteve të marrjes së tokës, në zonën me rëndësi për fondin e mbështetjes së investimeve strategjike, pavarësisht nga faza procedurale. Qeveria urdhëron njësitë e vetëqeverisjes vendore, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme që të pezullojnë procedurat e kalimit në pronësi të tokës së ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe të regjistrimit të akteve të marrjes së tokës, në zonën me rëndësi për fondin e mbështetjes së investimeve strategjike, pavarësisht nga faza procedurale.

Ndërkohë ngarkohen Ministria e Buqësisë dhe Zh-

DISA NGA NENET E LIGJIT 7501

- **NENI 1**
Në Republikën e Shqipërisë toka ndahet në:
a) Toka bujqësore të zëna me bimët e arrave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtet, kudo që ndodhen, në fshatra, në qytete e në qendra të tjera të banuara, pavarësisht nga madhësia e tyre;
b) toka të zëna me pyje, kullota e livadhe;
- **NENI 2**
Shteti i jep tokë personave fizike a juridike. Këta gëzojnë të drejtën e pronësisë dhe të gjithë të drejtat që përmbahen në këtë ligj. Ndalohet shitja dhe blerja e tokës.
- **NENI 5**
Familjet anëtare të kooperativës bujqësore, pas ndarjes së tokës kanë të drejtë të shkëputen dhe të dalin subjekt më vete, duke marrë në pronësi tokën bujqësore që u takon nga tërësia e subjektit ku bëjnë pjesë. Sasia dhe vendi ku do të jepet toka, përcaktohet nga komisioni i tokës. Në zonat kodrinore e malore, ku familjeve fshatrave nuk u sigurohet sipërfaqja e nevojshme e tokës bujqësore, shteti merr masa dhe u garanton burime të tjera jetese nëpërmjet subvencioneve, shtimit të investimeve për punësimin e njerëzve, vendosjes së asistencës sociale dhe lëvizjes së kontrolluar të popullatës, në bazë të një programi të caktuar nga Këshilli i Ministrave.
- **NENI 6**
Familjeve me banim në fshat, që nuk janë anëtare të kooperativës bujqësore dhe familjeve që punojnë e banojnë në ndërmarrjet bujqësore, u jepet në përdorim tokë bujqësore, madhësia e së cilës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

TAPITË
Pak kohë më parë nisi procesi i pajisjes me tapi për të gjithë familjet bujqësore që kanë marrë tokë në vitin 1991 me ligjin 7501. Personat që zotërojnë titujt e pronësisë dhe Aktet e Marrjes së Tokës në Përdorim, të fituara me ligjin për tokën bujqësore do të verifikohen nga komisionet vendore pranë njësiteve të qeverisjes vendore. Komisionet vendore do të verifikojnë nëse sipërfaqja e tokës, e dhënë në korrik të vitit 1991 është në përputhje me gjendjen familjare në atë moment dhe nëse dokumenti është lëshuar sipas rregullave. Domethënë nëse janë të rregullta firmat dhe vula. Më pas titujt e rregullt do të regjistruhen në Hipotekë. Familjet që kanë përfituar tokë me ligjin 7501 dhe kanë Aktin e Marrjes së Tokës në Përdorim duhet të bëjnë kërkesë pranë njësiteve të qeverisjes vendore për të marrë titullin e pronësisë, tapinë. Njësia e qeverisjes vendore bën verifikimin dhe më pas dosja kalon në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bëhet vetëm regjistrimin.

VENDIMI/ SHKRIHEN DREJTORITË



Krijohen 8 agjenci të reja rajonale për bujqësinë

Drejtoritë e Buqësisë nuk do të jenë më funksionale. Këshilli i Ministrave ka vendosur shkriren e tyre. Vendimi u bë publik nga kryeministri Edi Rama në një komunikim për mediat. Sipas tij, funksionin e tyre tashmë do ta kryejnë 4 agjenci rajonale për bujqësinë. Ndërkohë, do të krijohen edhe 4 agjenci rajonale të tjera për veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve, ku sipas kryeministrit njëra prej tyre do të ketë si qendër Elbasanin. "Kemi marrë vendimin për të finalizuar reformimin e strukturës së vjetër dhe të degraduar të drejtorive të bujqësisë. Më në fund nga sot nuk do të kemi më drejtori të bujqësisë dhe

kalojmë nga 13 drejtori të bujqësisë që ishin një sistem parazit, i degraduar në 4+4 agjenci rajonale. 4 agjenci rajonale tek seksioni bujqësor dhe 4 agjenci rajonale të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve. Njëra prej këtyre agjencive të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve do të ketë si qendër Elbasanin", -tha Rama. Sipas Ramës, përmes këtij procesi reformimi do të forcohet akoma më shumë Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural. Duke i konsideruar këto agjenci si një vlerë të shtuar, ai shtoi më tej se qeveria është e vendosur të garantojë sigurinë ushqimore dhe gjithë zinxhirin që përbën këtë sektor.

SKRAPAR-Pas aksidentit në Skrapar, ku një minibus në të cilin udhëtonin 26 nxënës doli nga rruga dhe u rrëzua 20 metra në greminë, policia ka arrestuar një ditë më pas, gjatë ditës së hënë shoferin e mjetit, Astrit Hysi, 52 vjeç. Ngjarja e rëndë ndodhi mëngjesin e së dielës, ku minibusi po transportonte nxënësit e shkollës 9-vjeçare dhe të mesme nga fshatrat Buzuq dhe Orizaj për në shkollën e Çorovodës, teksa u aksidentua në fshatin Vërzhëzhë. Pavarësisht se aksidenti ishte i rëndë, shoferi nuk ka pësuar dëmtime, madje ka qenë ai që ka lajmëruar policinë, ambulancën dhe zjarrfikësen, që u kanë ardhur në ndihmë nxënësve. Nga aksidenti

Nxënësit rrefejnë tmerrin: Shoferi humbi kontrollin, u rrokullisëm 4 herë

Aksidenti në Skrapar, arrestohet shoferi i minibusit që ra në greminë

AKSIDENTI

Nga aksidenti pësuan lëndime 11 nxënës, por pas mjekimit ata janë kthyer në shtëpi, ndërsa tre nxënës vijojnë të qëndrojnë në spital, dy në Berat dhe një në Tiranë. Ndërsa shoferi nuk ka pësuar dëmtime, madje ka qenë ai që ka lajmëruar policinë, ambulancën dhe zjarrfikësen, që u kanë ardhur në ndihmë nxënësve.

pësuan lëndime 11 nxënës, por pas mjekimit ata janë kthyer në shtëpi, ndërsa tre prej tyre vijojnë të qëndrojnë në spital, dy në Berat dhe një në Tiranë. Drejtuesi

i mjetit, Astrit Hysi deklaroi në polici se shkak i aksidentit u bë defekti me frenat. Por, sipas deklaratave të banorëve të zonës minibusi ka qenë me shpe-

jtësi të lartë, ku tentonte të parakalonte. Ndërkohë nxënësit që mbeten të plagosur nga aksidenti rrefejnë momentet e tmerrit ku thonë se kjo ngjarje i ka shokuar. "Kur morëm kthesën nuk e kontrolloi dot shoferi timonin dhe u rrokullisëm katër herë, ramë në një gropë. Kemi përjetuar momente të vështira, frikë, u tmerruam, u shokuam". Ekspertiza para-prake e policisë ka treguar se makina kishte pësuar një



Aksidenti në Skrapar

defekt teknik. Pas hetimeve rezultoi se 52 vjeçari Astrit Hysi nuk e kishte bërë kontrollin vjetor teknik të mjetit, pavarësisht se udhëtonte në një rrugë të vështirë si ajo e Çorovodës dhe transportonte fëmijë. Për këtë ai ka përfunduar në

pranga, ku akuzohet për "shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor" Sakaq, bëhet me dije se minibusi është shumë i vjetër dhe i amortizuar, ndërsa gomat i kishte jashtë standardeve, duke e nxjerrë jashtë rrugës pas frenimit.

Psikologjia e Shërbimit Social: Jemi vënë në lëvizje për të marrë në kontroll situatën e vajzave jetime

Vdekja e gruas shtatzënë në Kukës, vëllai: Çfarë do bëhet me 6 vajzat që la pas

KUKËS

Motra la 6 vajza të moshës 6-14 vjeçe, të cilat jetojnë në kushte ekstreme varfërie. Nuk e dimë ende se çfarë do bëhet me fatin e tyre". Kështu është shprehur ditën e djeshme vëllai i 39-vjeçarës, e cila humbi jetën së bashku me foshnjën në muajin e 9 të shtatzënisë. Teksa familja ka hapur dyert e mortit, mes lotësh dhe dhimbjes së madhe Rexhep Oka, vëllai i Nurije Poçi, tha se është i shqetësuar për fatin e 6 mbesave të tij, të cilat përveçse mbeten pa asnjë prej prindërve jetojnë në mes të mjerimit. Oka shprehet se ishte varfëria e tejskajshme që detyroi të motrën që në kushtet e depresionit të tentonte të ndërpriste shtatzëninë e saj e me pas të ndërronte jetë në spitalin e Kukësit. "Në gjendje më të dobët nuk ka ku shkon më, me qira. Varrimin e kanë bërë të bashkisë", u shpreh vëllai i viktimit, Rexhep Oka. Ndërkohë mjekët e maternitetit të Kukësit, bënë me dije se pacientja Nurije Poçi, u paraqit në urgjencën e maternitetit më datë 11.3. 2018 në gjendje të rëndë shëndetësore, me diagnozën fetus morti me laceracion dhe rrupturë të shprehur të uterusit. Sipas mjekëve mësohet se pacientja ka tentuar disa herë në shtëpi të dëmtojë barrën për shkak të problemeve sociale dhe është paraqitur në spital të gjendje të rënduar me hemorragji të shprehur. Gjatë ndërhyrjes kirurgjikale ka vijuar gjendja e rëndë e pacientes dhe pavarësisht përpjekjeve të mëdha të ekipit mjekësor e sëmurura ndërroi jetë në ora 01 e 30 të natës. Në lidhje me këtë ngjarje të rëndë, psikologjia e Shërbimit Social pranë Bashkisë Kukës thotë se kjo familje ka qenë në vëmendjen e shërbimit social, ndërsa është hartuar një plan konkret për të ndërhyrë dhe pasi familjarët të vendosin për kujdes-

Rexhep Oka: Mbesat jetojnë në kushte ekstreme varfërie



Materniteti i Kukësit



Viktima Nurije Poçi



VËLLAI VIKTIMËS

Mes lotësh dhe dhimbjes së madhe Rexhep Oka, vëllai i Nurije Poçi, tha se është i shqetësuar për fatin e 6 mbesave të tij, të cilat përveçse mbeten pa asnjë prej prindërve jetojnë në mes të mjerimit. Oka shprehet se ishte varfëria e tejskajshme që detyroi të motrën që në kushtet e depresionit të tentonte të ndërpriste shtatzëninë e saj e me pas të ndërronte jetë në spitalin e Kukësit.

tarin, do të ndjekim të gjitha hapat në bazë të ligjit. "Ndihem pak keq në këtë situatë por realisht kjo familje s'ka qenë jashtë vëmendjes së Shërbimeve Sociale. Kemi vite që jemi marrë me këtë familje

duke i ofruar të gjitha shërbimet e mundshme që kemi në dispozicion si bashki. Që djete jemi vënë në lëvizje për të marrë në kontroll situatën e 6 vajzave jetime. Po merremi me procedurat për të parë sit-

uatën hap pas hapi, edhe për ta ndjekur në vazhdimësi", thotë psikologjia.

Nurije Poçi prej disa vitesh jetonte së bashku me fëmijët në lagjen nr.3 të Kukësit (tek ish-Barakat). Fëmijë të 39-vjeçarës pohan se 39-vjeçarja jetonte në varfëri ekstreme, pasi nuk kishte asnjë të ardhur, ishte e papunë. Banorë të tjerë të këtij qyteti u shprehën se Nurija nuk arrinte të siguronte as bukën tëatë për 6 vajzat e saj, ndaj është detyruar që të bëjë vetë abort në banesën e saj me mjete

PSIKOLOGJIA
"Ndihem pak keq në këtë situatë, por realisht kjo familje s'ka qenë jashtë vëmendjes së Shërbimeve Sociale. Kemi vite që jemi marrë me këtë familje duke i ofruar të gjitha shërbimet e mundshme që kemi në dispozicion si bashki. Që djete jemi vënë në lëvizje për të marrë në kontroll situatën e 6 vajzave jetime", - thotë psikologjia.

Ministria Gjonaj në burgun e Peqinit: 100 punonjës, me rekorde kriminale

Ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj ka inspektuar ditën e djeshme Burgun e Peqinit. Gjonaj theksoi se reforma në sistem do të luftojë korruptionin në burgje. Ajo vuri theksin te integriteti dhe profesionalizimi i punonjësve të burgjeve, dhe se në këtë institucion janë konstatuar rreth 100 punonjës me rekorde kriminale, ndërsa 70 prej tyre janë të papërshtatshëm për pozicionet që mbajnë. "70 punonjës janë të papërshtatshëm me pozicionet e tyre, ndërsa 100 punonjës janë me akorde kriminale të cilët nuk duhet të ishin në sistemin e burgjeve", - u shpreh Gjo-naj. Ministria e Drejtësisë paralajmëroi ndryshime edhe sa i takon rekrutimit të punonjësve, ndërsa ftoi ish-ushtarakët dhe ish-punonjësit e policisë. "Nuk do të ketë me punonjës të emëruar nga drejtori apo ministri, por nëpërmjet Akademisë së Sigurisë. Me qëllim që jo vetëm të jenë të pa ndikuar politikisht por të aftë profesionalisht. Po nxisim ish-ushtarakët dhe ish-punonjësit e policisë për t'u rekrutuar si punonjës pranë Burgjeve".

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND
Ne date 15.03.2018 ne oren 16.00 ne zyren e permbaruesit gjyqesor privat Irlisa Tereziu PF me adrese ne Rr.Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane, zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se paluajtshme e Illojit Apartment, me sip.90 m², me adrese Lagjia 13 Plazh, Rruga Pavaresia, shkalla 1, kati 4, apartamenti 22, Durrres ne pronesi te Erjon Adem Estrefti.Cmimi ne ankand te dyte eshte ne vleren 3,080,000 (tre milion e tetedjete mije) Leke.

Shoqëria Përmbartimore "AFA-2010" sh.p.k shpall Ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme:
Pasurisë me Nr. 7/34, e Illojit "Apartment", me sip. 50.2 m², dhe sip.truall 19 m², ndodhur në Q. Memaliaj, Tepelenë ZK-2646, në pronësi të Skënder Feta Muka. Çmimi fillëtar në ankandin e parë është 537,124.64 Lekë.
Ankandi zhvillohet në datë 19.03.2018, ditën e Hënë ora 15.30 në ambientet e Shoqërisë Përmbartimore "AFA-2010" sh.p.k në adresën Rruga "Sulejman Delvina", Nd.51, H.9, Ap.1, Tiranë. Për më shumë info. Tel:044503458 ose E-maili shoqeria@permbartimoreafa2010@gmail.com

Kleriku Hysen Shehu e regjistroi dhe ia dha videon vjehrrit të vajzës

Dorjana Bezat

Arrestohet 21-vjeçarja, helmoi vjehrrën dhe u rrëfye tek hoxha

Marjana Cmeta i hodhi fotoksinë në ushqim

Mosmarrëveshjet e shpeshta mes 21-vjeçares Marjana Cmeta dhe vjehrrës së saj, Lirije Lami duket se kanë çuar në krimin e rëndë brenda familjes të ndodhur në prill të vitit të kaluar në Kamëz. Marjana Cmeta është arrestuar dhe në kuadër të operacionit "Heshtja e zgjatur" pas hetimeve të pandërprera, duke vlerësuar informacionet e grumbulluara si dhe provat e administruara. Pas vendimit të gjykatës janë ekzekutuar masat e arrestit për katër persona, mes tyre edhe bashkëshorti i viktimës, i cili kishte dijeni për krimin, por nuk ka treguar. Më vonë, detaje të reja u mësuan për vrasjen e 48-vjeçares Lirije Lami nga nusia e djalit të saj. "Balkanweb" raportoi se Marjana Cmeta, atëherë 20 vjeçe, pas konflikteve të vazhdueshme me vjehrrën, e cila nuk e pranonte si nusë e djalit i ka hedhur fotoksinë në ushqim duke e helmuar për vdekje.

Disa muaj pas ngjarjes, e reja u rrëfye tek hoxha Hysen Shehu për ngjarjen ku pranonte se ka qenë ajo që ka helmuar të vjehrrën dhe se kërkonte që "Allahu t'ia falte këtë mëkat".

Këtë rrëfim hoxha Hysen Shehu e pati regjistruar në video dhe vuri në dijeni Agim Lamin, bashkëshorti i viktimës dhe vjehrrin e nusës së arrestuar.



Lirije Lami

Po ashtu, në dijeni është vënë edhe një familjar i tyre, Arben Saliu. Hoxha Hysen Shehu, 45 vjeç është mes personave të arrestuar nga policia për "Moskallëzim krimi".

Ngjarja ka ndodhur në datën 30 prill të 2017-ës, por

vetëm tani policia arriti ta zbardhë duke arrestuar si autore të krimi 21-vjeçaren Marjana Cmeta. Po kështu, në pranga kanë përfunduar edhe bashkëshorti i viktimës Agim Lami, 50 vjeç dhe Arben Saliu, 41 vjeç, kushëri i Agimit.



Hoxha Hysen Shehu

NJOFTIMI I POLICISE

Nga Sektori i Hetimit të Krimeve të Rënda në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, nën drejtimin e Prokurorisë për Krimet e Rënda, u finalizua me sukses operacioni "Heshtja e Zgjatur", si rezultat i të cilit u bë i mundur lokalizimi, kapja dhe ekzekutimi i masave të sigurimit personal "Arrest në burg" të lëshuara nga Gjykata për Krimet e Rënda për shtetasit:

1. Marjana Cmeta, 21 vjeçe, banuese në Tiranë, për të cilën Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ka caktuar masën e sigurisë personale "Arrest në Burg" për veprën penale "Vrasje

për shkak të marrëdhënies familjare", parashikuar nga neni 79/c i Kodit Penal.

2. Agim Lami, 50 vjeç, lindur e banues në Tiranë, për të cilin Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ka caktuar masën e sigurisë personale "Arrest në Burg" për veprën penale "Moskallëzim krimi" parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal.

3. Hysen Shehu 45 vjeç, banues në Tiranë, për të cilin Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ka caktuar masën e sigurisë personale "Arrest në Burg" për veprën penale "Moskallëzim krimi" parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal.

4. Arben Saliu, 41 vjeç, banues në Tiranë, për të cil-

NGJARJA

Në datë 30 prill 2017, në zonën e Ish-Frutikulturës, në Kamëz është gjetur e pajetë në banesën e saj shtetasja Lirije Lami, 48 vjeçe, banuese në ish-Frutikulturë, Kamëz.

in Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ka caktuar masën e sigurisë personale "Arrest në Burg" për veprën penale "Moskallëzim krimi" parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal.

Ky operacion erdhi si rezultat i punës profesionale të pandërprerë, duke vlerësuar maksimalisht informacionet e grumbulluara si dhe provat e administruara nga grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë për Krimet e Rënda në lidhje me ngjarjen e ndodhur në datë 30 prill 2017, në zonën e Ish-Frutikulturës, Kamëz, ku është gjetur e pajetë në banesën e saj shtetasja Lirije Lami, 48 vjeçe. Nga tërësia e veprimeve hetimore rezultoi se autore e dyshuar e vrasjes së kësaj shtetaseje është shtetasja Marjana Cmeta, në atë kohë bashkëshortja e djalit të viktimës. Shkak i vrasjes dyshohet të jenë mosmarrëveshjet e shpeshta mes autorës së dyshuar dhe viktimës. Shtetasit e mëposhtëm: Agim Lami (bashkëshorti i viktimës), Arben Saliu (kushëri i Agimit) dhe Hysen Shehu kanë qenë në dijeni të ngjarjes së ndodhur dhe autorësisë së saj dhe nuk kanë kallëzuar pranë organeve kompetente duke fshehur ngjarjen. Materialet do t'i kalojnë Prokurorisë për Krimet e Rënda.

Mediat kosovare: Porositësit e drogës, grupe të fuqishme që operojnë në Zvicër

Kokaina në Durrës, nis hetimi pasuror për pronarin e kompanisë 'Arbri-Garden', Arbër Çekaj

Pas sekuestrimit të 613 kg kokainë në kontejnerin e kompanisë "Arbri Garden" në Durrës, Prokuroria e Krimeve të Rënda ka nisur verifikimin e pasurisë për pronarin Arbër Çekajn, si dhe për dy punonjësit Donald Lushaj dhe Armando Pezakun. Mësohet se prokuroria i ka drejtuar kërkesa bankave, zyrate të hipotekave dhe zyrate të transfertave të parave për veprimet e këtyre tre shtetasve të proceduar. Ndërkohë pronari i kompanisë Çekaj, vijon të jetë në kërkim pasi prej datës 24 shkurt 2017 ai rezultoi se ndodhet jashtë Shqipërisë. Në lidhje me këtë rast, kanë reaguar edhe media kosovare. Koha.net shkruan se një pjesë e kokainës së sekuestruar në Durrës në 28 shkurt, ishte porositur nga grupe të fuqishme trafikantësh kosovarë, të cilët veprojnë në Zvicër. "Grupe të fuqishme nga Kosova që



Arbër Çekaj

operojnë në tregun e kokainës në Zvicër mund të jenë porositësit e një pjesë të kokainës që u kap në Maminas të Durrësit mes datave 27-28 shkurt, dyshon grupi hetimor i çështjes "Kokaina" që po hetohet në Prokurorinë e Krimeve të Rënda në Tiranë. Ndërkohë që pjesa më e madhe e 613 kilogramëve kokainë kishte si treg kryesor kryeqytetin e Gjer-

manisë, Berlinin", shkruan koha.net. Grupi hetimor dyshon se një pjesë e kokainës do të dërgohej edhe në Zvicër, për shkak të udhëtimeve të shpeshta në Kosovë, konkretisht 6 herë brenda muajit, të menaxherit të kompanisë Donald Lushaj. Ndërkohë Lushaj dhe shoferi i kamionit Armando Pezaku, janë arrestuar nga policia ditën e operacionit.

EPSA SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR:

- Are me nr.33/26, e ndodhur ne Karpen, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.2099,vol.11, fq.202, me sip.2,000 m2, cmimi që do të shitet është **3.942.960** lekë.
- Are dhe truall me nr.1/88, e ndodhur ne Qerret, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.3101, vol.9, fq.34, me sip.1.770 m2 cmimi që do të shitet është **9.770.655** lekë.
- Are me nr.33/27, e ndodhur ne Karpen, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.2099, vol.1, fq.203, me sip.4,050 m2 cmimi që do të shitet është **7.984.494** lekë.
- Are me nr.70/9, e ndodhur ne Qerret, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.3101, vol.2, fq.106, me sip.6,460 m2 cmimi që do të shitet është **5.094.305** lekë.
- Njësi me nr.15/22+1-N1 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistrimi hipotekor 14/69, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.116 m2 vlerësohet me vlerën e **10.062.434** lekë.
- Njësi me nr.15/22+1-N2 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistrimi hipotekor 14/70, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.91 m2 vlerësohet me vlerën e **7.893.806** lekë.
- Njësi me nr.15/22+1-N3 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistrimi hipotekor 15/71, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.95 m2 vlerësohet me vlerën e **8.240.786**lekë.
- Njësi me nr.15/22+1-N4 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistrimi hipotekor 15/72, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.211 m2 vlerësohet me vlerën e **18.303.221** lekë.
- Bodrum me nr.15/22+1-B e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistrimi hipotekor 130/176, vl.2005-2007, datë 24.09.2007 me sip.609 m2 vlerësohet me vlerën e **14.734.842** lekë.

Te gjitha pasuritë e sipërcituara jane hipotekuar në favor te **Banka Raiffeisen sha**. Ankandi zhvillohet ne datë **09.04.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratarri", K.6,Tirane, Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

Të rinjtë vlerësojnë maksimalisht temat, certifikatë mirënjohjeje për Jones e Toubi-n

Studentët e 'Luarasi', leksion të hapur me dy ekspertë të huaj

Aelita Mani: Përgatisim liderët e së ardhmes



Voltiza Duro

Studentët e vitit të dytë Financë Bankë në Kolegjin Universitar Luarasi, kanë pasur mundësinë të jenë pjesë e dy leksioneve të hapura të mbajtura nga profesorë e ekspertë të huaj. Ditën e djeshme, në auditorët e këtij institucioni arsimor elitari, kanë qenë të pranishëm Tom Jones dhe Ron Toubi që shpjeguan para studentëve leksione rreth menaxhimit të riskut dhe vizionit që i bën liderë në të ardhmen të rinjtë. E pyetur nga "Gazeta Shqiptare", shefja e Departamentit të Ekonomiksit në Kolegjin Universitar "Luarasi", Aelita Mani tregon se këta mentorë japin shembullin më të mirë për studentët, orientimin e tyre në karrierë e të ardhmen drejt rrugës së liderit. "Të ftuarit e sotëm janë trajnerë të peshës botërore që trajnojnë studentët në të 6-ta kontinentet. Studentëve sot (dje) iu dha mundësia të shohin përtej leksioneve dhe marrin përvojën ndërkombëtare dhe individuale të këtyre ekspertëve si dhe arrijnë të shikojnë shumë më shumë mundësi në botën globale, pasi ne i përgatisim studentët që të jenë qytetarë dhe punonjës globalë".



Leksioni i hapur me ekspertë të huaj në Kolegjin Universitar "Luarasi"

profesorëve të huaj iu uroi mirëseardhjen Dekani i Fakultetit Ekonomik prof. as. Mateo Spaho si dhe në shenjë falënderimi për kontributin e dhënë për mentorimin e studentëve, dr. Aelita Mani iu dorëzoi një certifikatë mirënjohjeje ekspertëve nga ana e Kolegjit Universitar Luarasi.



SHEFJA E DEPARTAMENTIT TË EKONOMIKSIT NË "LUARASI", AELITA MANI

"Të ftuarit e sotëm janë trajnerë të peshës botërore që trajnojnë studentët në të 6-ta kontinentet. Studentëve sot (dje) iu dha mundësia të shohin përtej leksioneve dhe marrin përvojën ndërkombëtare dhe individuale të këtyre ekspertëve si dhe arrijnë të shikojnë shumë më shumë mundësi në botën globale, pasi ne i përgatisim studentët që të jenë qytetarë dhe punonjës globalë".

KUFIZIM QARKULLIMI NË KËTO RRUË:

- **Nga ora 07:00 deri në orën 19:00** në segmentin e blv. "Dëshmorët e Kombit" nga kryqëzimi me rrugën "Myslym Shyri" deri blv. Zhanë D'Ark.
 - Për këtë segment qarkullimi i automjeteve, mjeteve të emergjencës dhe Policisë së Shtetit, do të bëhet si më poshtë:
 - Në rrugën "Myslym Shyri" në kryqëzimin me blv. "Dëshmorët e Kombit", drejtim i detyruar majtas, sipas sensit të lëvizjes.
 - Në blv. "Zhanë D'Ark", drejtim i detyruar drejt-majtas, sipas sensit të lëvizjes.
- **Nga ora 00:00 deri në orën 24:00** në segmentin e blv. "Dëshmorët e Kombit" nga kryqëzimi me blv. "Bajram Curri" deri rrugën "Ismail Qemali".
 - Për këtë segment qarkullimi i automjeteve, mjeteve të emergjencës dhe Policisë së Shtetit do të bëhet si më poshtë:
 - Në blv. "Bajram Curri" në kryqëzimin me blv. "Dëshmorët e Kombit", drejtim i detyruar drejt-majtas, sipas sensit të lëvizjes.
 - Në rrugën "Ismail Qemali" me blv. "Dëshmorët e Kombit", drejtim i detyruar drejt-majtas, sipas sensit të lëvizjes.
- **Nga 00:00 e datës 14 Mars deri në orën 04:00 të datës 15 Mars** në segmentin e rrugëve: "Pjetër Bogdani" nga "Ibrahim Rugova" deri "Sami Frashëri"; "Brigada VIII"; "Ibrahim Rugova" nga kryqëzimi me blv. "Bajram Curri" deri me rrugën "Ismail Qemali".
 - Për këto segmente qarkullimi i automjeteve, mjeteve të emergjencës dhe Policisë së Shtetit do të bëhet si më poshtë:
 - Në blv. "Bajram Curri" në kryqëzimin me "Ibrahim Rugovën", drejtim i detyruar drejt, sipas sensit të lëvizjes.
 - Në rrugën "Ismail Qemali" në kryqëzimin me "Ibrahim Rugovën", drejtim i detyruar drejt-majtas, sipas sensit të lëvizjes.
- Mjetet e transportit publik me itinerar në blv. "Dëshmorët e Kombit" do të devijohen në rrugën "Ibrahim Rugova" - blv. "Gjergj Fishta" - "Sami Frashëri" për të vazhduar në sheshin Willson për njërin drejtim. Për drejtimin tjetër, nga sheshi Willson - "Sami Frashëri" - blv. "Bajram Curri" - ura e Rr. "Eibasanit" për të vazhduar në rrugën "George W. Bush".

Aktivite, muzikë e argëtim për qytetarët

Dita e Verës, ja cilat janë segmentet rrugore që do të bllokohen sot

Kryeqyteti po feston sot Ditën e Verës, nën shoqërimin e aktiviteteve të shumta të organizuara nga Bashkia e Tiranës. Por kjo e fundit, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, për mbarrëvajtjen e kësaj dite, ka marrë të gjitha masat për kufizimin e qarkullimit të automjeteve në disa prej rrugëve, ku është planifikuar zhvillimi i aktiviteteve. Përkatesisht do të ketë ndalim lëvizjeje prej orës 07:00 deri në orën 19:00 në segmentin e bulevardit "Dëshmorët e Kombit" nga kryqëzimi me rrugën "Myslym Shyri" deri në bulevardin Zhanë D'Ark. Bashkia e Tiranës ka bërë me dije, gjithashtu, se prej orës 00:00 deri në orën 24:00, do të ketë kufizim të lëvizjeve në segmentin e bulevardit "Dëshmorët e Kombit" nga kryqëzimi me bulevardin "Bajram Curri" deri rrugën "Ismail Qemali". Edhe në segmentin e rrugëve; "Pjetër Bogdani" nga "Ibrahim Rugova" deri "Sami Frashëri"; "Brigada VIII"; "Ibrahim Rugova" nga kryqëzimi me bulevardin "Bajram Curri" deri me rrugën "Ismail Qemali", prej orës 00:00 të datës 14 mars deri në orën 04:00 të datës 15 mars do të ketë ndalim të kalimit të automjeteve. Ndërkaq, qytetarët kanë mundësinë të argëtohen sot me aktivitetet sportive, muzikën e këngëtarët më të mirë të vendit, produktet artizanale e ekspozitat e ndryshme.



CEREMONIA



Pajisje të reja për Shërbimin Zjarrfikës të kryeqytetit

Bazë e re materiale, uniforma, flikëse zjarri dhe mjete të tjera ndihmëse janë pajisjet e reja që do të vihen në dispozicion të Shërbimit Zjarrfikës të Tiranës. Kryebashkiaku Erion Veliaj, gjatë ceremonisë së dorëzimit të pajisjeve në Repartin e Zjarrfikësve në kryeqytet, theksoi se falë përmirësimit të pajisjeve dhe të kushteve të punës, shërbimi zjarrfikës do e ketë shumë herë më të lehtë për të përballuar me sukses stinën e verës për menaxhimin e rasteve të zjarreve. Më tej Veliaj i bëri thirrje të gjithë qytetarëve që të japin ndihmën e tyre duke sinjalizuar në kohë çdo rast problematik që mund të shfaqet.



Manastirliu: Forcojmë masat kundër dhunës ndaj grave

Qeveria shqiptare ka në fokus fuqizimin ekonomik dhe social të grave që jetojnë në zonat rurale nëpërmjet skemave të punësimit dhe gjithëpërfshirjes. Kjo është ajo çka ka deklaruar ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu gjatë sesionit të 62 të Komisionit për Statutin e Gruas, që po mbahet në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Më tej ministrja evidentoi sfidat që përballlet gruaja shqiptare në zonat rurale si pabarazia gjinore, parandalimi i dhunës ndaj grave, si dhe aksesin në shërbimet shëndetësore e sociale.

Agjencia e Trajtit të Pronave publikon listën me 871 përfituesit

ATP: Dosjet e vitit 1995, pronarët që kompensohen

Ish-pronarët, aplikimet e ezauruara

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtit të Pronave publikon listën me 871 pronarë, të cilëve u është njohur të drejta për kompensim. Dosjet i përkasin vitit 1995. Lista me vlerësimin përfundimtar, ku pjesa më e madhe e dosjeve konsiderohen subjekte të kompensuar është botuar dje në Fletoren Zyrtare. Ndërkohë, gjatë procesit të verifikimit të vendimeve të administruara pranë arkivës së ATP-së janë identifikuar gjithsej 6838 vendime të vitit 1995, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit subjekteve të shpronësuara, për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Të dhënat lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuara, sipërfaqja e njohur për kompensim, mangësitë në dokumentacion apo vlerësimin përkatës jepen të de-



tajua në regjistrin që shpëron këtë njoftim.

DOSJET

Me përfundimin e procesit të vlerësimit të vendi-

meve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit për vitin 1995, numri total i vendimeve të viteve 1993, 1994 dhe 1995

të publikuara arrin në 10,763. Aktualisht, ATP vijon punën me dosjet e 1996-s. Ligji i ri përcakton një afat 3-vjeçar për vlerësimin

ekonomik të 26 mijë vendimeve të formës së prerë që janë të arkivuara në Agjencinë. Kjo do të thotë që deri në 2019-n, kjo praktikë duhet të jetë përmbyllur.

KOMPENSIMI FIZIK

Agjencia e Pronës ka në zotërim 23 mijë hektarë tokë bujqësore, për të cilat ka përfunduar më herët edhe vlerësimin ekonomik, të cilat do të përdoren për skemën e kompensimit fizik. Për ndarjen e kësaj sipërfaqeje, dy do të jenë kriteret bazë. Kriteri i parë është rendi kronologjik i vendimeve, që do të thotë se sikurse kompensimi financiar, edhe ky kompensim do të fillojë me vendimet më të vjetra në kohë.

Kriteri i dytë lidhet me vendndodhjen e pronës që do të përfitojnë si kompensim fizik. Pra, pronari do të kompensohet me një pronë nga fondi fizik, e cila gjeografikisht është më afër me pronën që i është njohur për kompensim. Në lidhje me dokumentet që duhet të depozitohen, ato nuk ndryshojnë, por mbeten të njëjta, si në rastin e kompensimit financiar e kompensimit formulari i aplikimit, i cili është specifik për secilin rast. Në total janë 26 mijë vendime të formës së prerë, të cilat presin të kompensohen. Bazuar në ligjin e ri, Agjencia e Trajtit të Pronave ka nisur një proces të rivlerësimit, ku një metër katror tokë do të llogaritet me çmimet e tregut, por zëri kadastral nuk do të jetë ky i sotmi, por ai që ka pasur pronë në çastin e shpronësimit.

DOSJET E VITIT 1995/ EMRAT E PRONARËVE, TË CILËVE U ËSHTË NJOHUR TË DREJTA PËR KOMPENSIM

| Qarku | Emri (Subjekti Kerkues) | Atesia | Mbiemri (Subjekti Kerkues) | VLERESIMI | SHENIME |
|------------------------------------|--|----------------|----------------------------|-----------|------------------------------------|
| (Vijon nga numri i djeshëm) | | | | | |
| Tiranë | SELIM, MABULE SKENDERI, HUTA | -1,755,602,002 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Aldie Thanasi | 2,725,750 | | | |
| Korçë | Jani Frasherit | -31,654,025 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | QIQRI | | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | ALFRED GJOKA | 4,712,490 | | | |
| Lezhë | Hasan Kavaja, trashigimtarët ligjorë pa emër | -3,474,000 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Lezhë | Kujtim Litja | -1,262,037 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Lezhë | Nurije Lahi | -280,710 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | RAMAZAN XHEPA | -116,049,755 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | HAMIDE LUNDRA | -92,067 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | Muharem Deliu | -334,845 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Vasilqaj Ndini | -13,417,600 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Muhamet Galeshi | -320,500 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Qani Sulo | | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Sazan Nebiu | | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Servet Ago | -1,588,943 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Joran Marko | -1,807,528 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | HYNSI SKENDERI | -89,599,000 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Sotir Karezhi | | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Qezap Ocka | 243,000 | | | |
| Elbasan | ELMAZ HASA | -5,874,000 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Dibër | HALIL SKANA | -134,530 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | SKENDER DOÇI | -585,929,095 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | ALI ZAJMI | 8,271,765 | | | |
| Korçë | Barbdo Reme Kardihiqi | -1,472,300 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Petrit Njaz Shehu | -457,930 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Vasil Kicollari | -9,985,169 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |

| Qarku | Emri (Subjekti Kerkues) | Atesia | Mbiemri (Subjekti Kerkues) | VLERESIMI | SHENIME |
|-------------|-------------------------|----------------|----------------------------|-----------|------------------------------------|
| Korçë | Kristaq Lako | -7,711,265 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Shkodër | Jap Kastrioti | -89,162 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Dibër | Veli Vrançi | -9,927,940 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Dhimitraq Gusho | -45,402,465 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | HAXHI ÇULLHAJ | -88,200,820 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | FATMIR ÇULLHAJ | -129,649,418 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Xhevaire Selmani | -11,640 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Kukës | Hasan Hysen Peka | -4,987,864 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | | | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Mahmude Isai | | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Aishe Kadare | | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | | | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Mitro Gjoni | | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Illa Samaraj | -2,515,580 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Shkodër | Eduart Gjinaj | -131,912,220 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Shkodër | Ndoc Gjinaj | -129,476,820 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | FATMIR BELISHOVA | | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Izet Sali | -70,360 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | PETRIT MUMAJESI | -5,095,817,315 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Zenepe Bazati | -2,346,615 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | SHABAN CASLLI | -58,814,948 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Edmond Merlika | -6,796,262 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Gani Subashi | -2,715,149 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Haki e Shpetim Pupriqi | -10,629,815 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Mitat Matraku | -9,466,450 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Kostajq Tushi | -7,234,500 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Shkodër | Gjon Kol Jaku | -24,352,449 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | Xhafer Gjini | -1,720,780 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Sopot Isafi | -534,320 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Gjirokastrë | Sotir Kondi | | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |

| Qarku | Emri (Subjekti Kerkues) | Atesia | Mbiemri (Subjekti Kerkues) | VLERESIMI | SHENIME |
|-------------|---|--------------|----------------------------|-----------|------------------------------------|
| Tiranë | YLVIE VATHI | | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Shkodër | Hamid Karakaci | -2,683,590 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Elbasan | Bajram Mana, Enver Mana, Hajrije Mana, Hava M | -21,329,970 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | SELMAN BEKA | -73,823,750 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Gjirokastrë | Dhimosken Vangelj Papa | -136,669 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Shpresa Frasherit | -7,116,000 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Arto gjeneral | -2,977,200 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Kukës | Islam Musli Kastrioti | | | | |
| Korçë | Rakip Jazgji | 172,000 | | | |
| Tiranë | ARTUR KULLAKSHI | -35,821,780 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | HYSEN XHEPA | -154,778,100 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Isuf Aliçe | | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Irfan Jashari | | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Vasit Gjiksana | | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Lida Zotka | 1,032,977 | | | |
| Elbasan | XHEVDET KASA | -8,674,956 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Petrit Busho | -7,099,476 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | HARILLAQ VASILI | | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | MYSLIYM DEMNERI | -226,346,048 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Kukës | Gariq Rafat Hallaj | -1,454 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Kukës | Zyflir Shehu | -49,608 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Kukës | Sadik Shaban Hoxha | -253,305 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Kukës | Bajram Jashari Hllaj | -111,500 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Kukës | Xhafer Ljiman Tafasi | -90,336 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Shkodër | Vehid Ymer Ramadani | -829,800 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Shkodër | Ndoc Alekaj | -6,053,205 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | EQERE MYDERIZI | -37,541,980 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | GEZIM STAFJA | -1,909,116 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Mikel Shkëzaj | -4,036,880 | | | Subjekti konsiderohet i kompensuar |
| Elbasan | SHPRESA BRETAKOSA | 1,265,400 | | | |

| | | | |
|---------|--|--------------|------------------------------------|
| Elbasan | SHEMSI DAU | -36,960,000 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Xhevdet Dervishi | -11,009,300 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | ASTRIT HOXHA | -144,995,052 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | ELENI NAKO | -330,729,840 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Shkodër | Gezim Kastrati | -1,537,500 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | SADEDIN XHAFA | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | NAJME BIBA | 14,867,118 | |
| Dibër | SKENDER TURJA | -10,860 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | MUHAMED KADU | -142,881,808 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Berat | Abdullah Luari | -136,472 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Elbasan | KADRI BERDELLIMA | -57,150 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Afrdita Gusho | -44,043,091 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Elbasan | RAMAZAN MECIA | -7,684,006 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Elbasan | HYQMET SHENGJERGJI | -125,237,072 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Shkodër | Sejfi Baja | -105,200 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | BASHKIM VORPSI | -125,231,590 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | LEONIDHA POPA | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | GANI HIDRI | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Besnik Domi | -3,580,225 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | ETHEM CENOMERI | -160,016,077 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | Ymer Gjini | -3,239,700 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Qamil Sanco | -100,800 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Shkodër | Qemal Shaban Elezi | -1,610,856 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | NDOC SHLLAKU | -1,858,566 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Zeqirje Pipi | -6,012,749 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Jusuf Klla | -44,740,797 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Fier | Mihalq Furxhiu | -59,662,254 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | | -566,590,699 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Shkodër | Fahri Omari, Virtyt Omari | -66,293,100 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Mikel Shkëzi | -56,255,980 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | QEMAL KARAOSSMANI | 37,665,900 | |
| Kukës | Rrustem dhe Hysen Gjyriqi | -6,199,556 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | HAIJRI CIZMJA | -214,213,594 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Nikolla Suraj | -1,723,912 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Fier | Anesti Sefa | -1,416,880 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | MARK SHLLAKU | -1,860,934 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Sulho Papadhima | -53,181,000 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Sulho Papadhima | -53,181,000 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Simo Zupa | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Kosta Kumbuli | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Jorgji Kondi | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Sotir Dilo | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Sabrie Barjami | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Resul Demi | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Selim Pengjili | -2,035,258 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Qemal Kaloshi | -5,496,917 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Zyra Kulli | -914,250 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Hysen Gjyza | -17,463,931 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Sejfulla Hyka | -3,088,300 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Gezim Kasmi | -7,098,000 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Hysen Blushi | -16,979,018 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | BAJAME DERVISHI | -3,205,690 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | NURJEF KOLLÇAKU | -1,302,385 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Nage Thomaniku | -2,848,000 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | Jorgji Panteqi | 12,724,110 | |
| Tiranë | BAJRAM NDEU | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Dibër | JAHO FASLLIU | -48,600 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | ARTEMISI DOLLANI | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | Emine Gjini, Hekuran Gjini, Mustafa Gjini, Shy | -523,220 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |

| | | | |
|---------|--------------------------------|--------------|------------------------------------|
| Elbasan | ALUSH SARAÇI | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | SOTIRA KUSHTA | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | trashëgimtarët | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Razie Meani | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | BESNIK PETRELA | 1,569,345 | |
| Elbasan | IKE, SANJIE DUSHKU | -16,930,860 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Filip Kota | -3,550,000 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Kristaq Skali | -11,030,902 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Zarifë Plumbi | -99,584,237 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Bajram Muharemi | -286,017 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Resmije Petriti | -4,227,648 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Hysen Latka | -52,668 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | ISAEMINI | -5,329,616 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Ferdit Hashi | -5,795,890 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Llambi Spiro | -64,333,088 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Llambi Spiro | 4,139,400 | |
| Tiranë | Hamit Allmuça | -554,184,832 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | MIRJETA KUSI | -10,405,293 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Sinan Zemni | -22,923,678 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Astrit Zere | -8,234,320 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Kukës | Sali Ram Sheta | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Evanthi Kocaqi | -5,960,000 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Shkodër | Sheuki Rroji | 757,826 | |
| Shkodër | Emine Tari | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | MALIQ TAFI | -112,559,168 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | trashëgimtarët | 0 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Berat | Eleonora Ziu | -203,400 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Theodora Papadhima | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | MEHMET DAJA | -239,729,990 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Shkodër | Xhemal Sulejman Balla | -4,569,724 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | BEDRI BULKU | -299,116,000 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Llazi Barnashi | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Stavri Llambiri | -245,000 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Rajmond Kercova | -135,671,200 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Llambi Kosta | -3,464,080 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | Nurije Mati | 8,789,681 | |
| Korçë | Pavlo Beri | -4,402,936 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Vlash Jani Koljaka | -9,212,870 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Flamur Sala | -34,700,325 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Lefter Çorbachiu | -2,209,080 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | HAMIDE MUCA (MEMA) | -138,190,398 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | SULEJMAN SULEJMANI | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | | 37,676,164 | |
| Durrës | | -9,616,600 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Enver Balla | -10,245,952 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | Hysen Bexholli | -220,920 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Shkodër | Myzafer Garuci | -897,783 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Enver Shajri | -19,600,600 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Llambi Kondo | -72,400 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Oresti Prodoni, Thomaq Prodoni | -150,425 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Pandeli Prifti | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Elbasan | LUMNJE GRACANI | 5,360,880 | |
| Elbasan | NGJAJTI BIMBASHI | -88,421,080 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Aslan Xhakolli | -999,450 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | | -1,370,000 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Hivzi Malka | -2,904,220 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Petrika Viso | -594,509 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |

| | | | |
|-------------|------------------------|----------------|------------------------------------|
| Tiranë | NAIM VRETO (ELBASANI) | -357,175,933 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Dhimitërulla Mulla | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | ALI FARKA | -208,049,454 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | RAMAZAN QOQJA | -286,544,700 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Ah Xhema | -45,005,000 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Hail Myderriz | -18,948,400 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Vito Antigoni Duglaska | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Dhaver, Poci | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Odhise Konomi | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Ibrahim Duda | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | HAMIDE MUCA (MEMA) | -165,702,200 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | FADIL METANI | -156,548,784 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | KUJTIM BARA | -165,846,980 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | MUSTAFA MENERI | -36,123,682 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Shkodër | Shan Milleta | -1,650,930 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Shkodër | Ahmet Osja | -106,819,842 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Kostandin Heba | | |
| Tiranë | BESIM BASTARI | -3,012,360 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Ndue Koku | -189,497,300 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | QEMAL DAJA | 10,750,060 | |
| Tiranë | QEMAL DAJA | 2,928,490 | |
| Tiranë | Hazir Kërçuku | 3,144,470 | |
| Durrës | Riza Deliallisi | -15,235,000 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Haxhi Keçi | -7,056,852 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Elbasan | SHYQYRI BEXHET ARAPI | -82,993,400 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | SHEFI PETRELA | -387,203,846 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Prokop Andrea | -1,156,212 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Ksenofon Xhaxho | -1,088,904 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | MEHMET BARDHOSHI | 11,518,668 | |
| Gjyrokastër | Hasim Myftar Zaçe | 4,549,631 | |
| Gjyrokastër | Andrea Kukureci | -1,800,173 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Lefter Pepo | -192,360 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Kristaq Bimbhi | -10,036,600 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | ISLAM BRAHJA | -994,300 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | XHEVAHIR MUÇA | -106,518,380 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Gjyrokastër | Hysen Zenel Hadëri | 2,091,144 | |
| Korçë | Thoma Pano | -27,297,582 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | VASIL MINEU | -21,964,550 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Durrës | Albert Pupa | -69,709,150 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | BESIM KARAJ | | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Elbasan | LIMAN GOLI | 208,800 | |
| Tiranë | HASAN SURELI | -638,209,040 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | FEHMI TOSKA | -7,161,912 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | Jakup Kokonozi | -68,838,770 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Lezhë | Marka Caka | -854,010 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Jorgjia Triha | -152,500 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Elbasan | NAIM KARAKYZJA | -49,157,840 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Korçë | Viktor Shkëmbi | -246,048 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Shkodër | Moisi Mozli | -26,566,800 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Shkodër | Pal Ndoc Marku | -40,258,230 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | HYSNI MAZREKU | -1,021,625,200 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Spiro Gjati | -434,718 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Xhafer Xhelili | -151,262 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Vlorë | Feruzë shehli | -232,752 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | SKENDER MUHARREM HUTA | -396,939,704 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | IBRAHIM TURKU | -115,214,722 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Tiranë | HYSEN DERVISHI | -443,434,136 | Subjetti konsiderohet i kompensuar |
| Gjyrokastër | | | |

(Vijon nesër)

Punëtorët tregojnë stresin, problematikat e presionin e ushtruar nga shefat

Rreth 32% e punonjësve të call center, probleme me dëgjimin e shikimin

Kordoni: Kemi konstatuar shkelje të kontratës

Voltiza Duro

Në vendin tonë numërohen rreth 30 mijë punonjës në sektorin e call center, i cili vazhdon të mbetet një zgjidhje punësimit, veçanërisht për të rinjtë që nuk mund të gjejnë një punë në profesionin ku janë diplomuar. Por sipas një studimi të kryer së fundmi, rezultojnë se 31.5% e të punësuarve në këtë sektor, kanë shfaqur probleme shëndetësore me dëgjimin apo shikimin. E pyetur nga "Gazeta Shqiptare", Alma Kordoni,

PUNONJËSIT

Vetë personat që punojnë në këtë sektor, tregojnë vështirësitë që hasin përditë gjatë punës e stresin që iu duhet të kalojnë madje në shumë raste presionin e ushtruar nga shefat e tyre. "Kam rreth dy vite që punoj në call center,

e po shkatërrohem nga nervat. Të rrish gjatë orë me kufje, në një kohë që supervizori ushtron presion që të bëjmë sa më shumë kontrata, është tejet e lodhshme. Por ka pagesën e mirë e si mësuese nuk kam mundur të siguroj një vend pune, kështu që më duhet të rri

për të përballuar jetesën, qiranë e shpenzimet e tjera", tregon për "GSH" 27 vjeçarja me inicialet A.R. Por jo vetëm kaq, të rinjtë shpeshherë thonë se kanë probleme shëndetësore, veçanërisht me dëgjimin e shikimin. "Bëra një vizitë para një muaji e më tha

mjeku që duhet të lej punën pasi kisha dëmtim të dëgjimit nga puna me kufje. Unë punoj në dy call center, në njërin 4 orë dhe në tjetrin 6 orë, se duhet të mbaj familjen, e ky është i vetmi burim të ardhurash", thotë për "GSH", G.B, 31 vjeçari nga kryeqyteti.

“Të rrish gjashtë orë me kufje, në një kohë që supervizori ushtron presion që të bëjmë sa më shumë kontrata, është tejet e lodhshme. Por ka pagesën e mirë dhe si mësuese nuk kam mundur të siguroj një vend pune, kështu që më duhet të rri për të përballuar jetesën, qiranë e shpenzimet e tjera”, - tregon për "GSH" 27-vjeçarja me inicialet A.R.



menaxhere projektsh pranë shoqatës TFL tregon se call center është një sektor goxha i fuqishëm në vendin tonë por që mbart problematikat e shumta. "Ky është një sektor goxha i fuqishëm dhe ofron kapacitete me rreth 50-150 punëtorë për kompani, pjesa më e madhe e të cilëve janë të rinj të moshës 18-30 vjeç. Shumica janë të arsimuar me shkollë të mesme, të lartë, madje edhe me doktoraturë. Por, pjesa më e madhe e problemeve që kemi evidentuar gjatë studimit lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen në punë, ku 31.5% e punonjësve kanë probleme shëndetësore të krijuara në vendin e punës. Edhe pagesat e bonuseve herë pas here nuk futen në sistemin e pagës reale por si një pagesë ekstra", thekson Kordoni. Kjo e fundit shton se është konstatuar edhe shkelje të kontratës nga të dyja palët, punëtorët e kompanive dhe punëdhënësit, si dhe bën me dije se në shumë raste nuk funksionojnë realisht keshillat e sigurisë dhe mbrojtjes në punë.

STUDIMI

"Pjesa më e madhe e problemeve që kemi evidentuar gjatë studimit lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen në punë, ku 31.5% e punonjësve kanë probleme shëndetësore të krijuara në vendin e punës. Edhe pagesat e bonuseve herë pas here nuk futen në sistemin e pagës reale, por si një pagesë ekstra", - thekson Kordoni.

PLANET ME KONTRATË SUPERSMART PËR BIZNESE DHE INDIVIDË

MUNDËSI
PËR TË GJITHË

TARIFAT
MË TË MIRA

Me **Super Smart**, përfito **tarifat më të mira**, më shumë **minuta** e **SMS** dhe mbi të gjitha **Internet** që nuk mbaron!

www.albtelecom.al [f/albtelecom.al](https://www.facebook.com/albtelecom.al) 123

ALBtelecom
...me ju të parët!

VIP

Suplement
Pages

Emërkurë 14 Mars 2018

GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- Rama përballlet me "peshqit e mëdhenj" të qeverisë në Elbasan
- Jul Deda: Rama ua mbylli gojën artistëve dhe teatërdashësve me një plagjiaturë...
- Boçi i PD: Rama e mblodhi qeverinë të stabilimenti i peshkut
- Pozitat në Shkodër, këngëtarja Ndoci sulmon kreun e PD

Emina shfaq foton e ëmbël të vajzës, veshur me kostum popullor shqiptar



Joni super i dashuruar, "E bukura dhe Bisha" në Disneyland me Merlin



Flet moderatorja: Si janë përzgjedhur fëmijët



alketavejsiu "Në Kurthin e Peter Pan"
Vetem pak dite na ndajne nga fluturimi i ri ne @rtviklan ... Nje perralle moderne per ata qe nuk duan te rriten kurre!
Cilet jane personazhet vip qe do te donit te intervistoheshin nga femijet?

View all 40 comments

marbi_bitri @alketavejsiu

sarah_hallil02 @arditgjbrea

sonja_hoxha @soni_malaj @arditgjbrea

@lamflorimmalesi @zinizin



18,246 vIEWS

3 DAYS AGO



"Në kurthin e Piter Pan", ALKETA VEJSIU zbulon krahun e saj të djathtë

Nis emisioni i shumëpritur, ja kush janë protagonistët

Intervista

Flet moderatorja: Si janë përzgjedhur fëmijët

"Në kurthin e Piter Pan", Alketa Vejsiu zbulon krahun e saj të djathtë


Nis emisioni i shumëpritur, ja kush janë protagonistët



Rudina Dembacaj

Pamela Aliaj

Pej kohësh përfillet në media se do të nisë së shpejti një emision për fëmijë në Klan Tv i quajtur "Në kurthin e Piter Pan". Duke qenë se emisioni do të drejtohet nga ikona e Klanit, Alketa Vejsiu, ka qenë ajo e para, e cila përmes postimeve të ndryshme në faqen e saj në "Instagram" na ka zbuluar se cilët do të jenë të ftuarit "Vip" të cilët do të jenë pjesë e emisionit dhe e lojërave me fëmijët. Në një intervistë ekskluzive për "Vip Pages" të "Gazeta Shqiptare", Alketa ka zbuluar se cili personazh VIP do të jetë "krahun i saj i djathtë" përgjatë gjithë puntatave.



Alketa Vejsiu



Gjithashtu, ajo ka zbuluar edhe sa personazhe VIP do të jenë pjesë e emisionit për fëmijë çdo mbrëmje.

A është ndonjëri fëmijë i ndonjë personazhi të njohur që do të marrë pjesë?

Për më tepër zbulojeni në intervistën e mëposhtme.

Kur pritet të nis emisioni "Në kurthin e Piter Pan"? Emisioni do të nisë në 19 mars.

Cila pritet të jetë surpriza e premierës?

Supriza padyshim do të jenë fëmijët.

Si është bërë përzgjedhja e fëmijëve?

Janë zgjedhur padyshim më të mirët dhe më meritë.

A është ndonjëri fëmijë i ndonjë personazhi të njohur që do të marrë pjesë?

Jo, janë të gjithë fëmijë të thjeshtë që mburojë kanë pasur talentin.

A është e vërtetë që do të ketë dy personazhe VIP të përhershëm në emision?

Do të jenë tre personazhe VIP të ndryshëm çdo natë.

A është pjesë e tyre edhe aktorja Rudina Dembacaj?

Kush tjetër do të jetë, nëse po?

Po, Rudina do jetë krahun im i djathtë. Ajo do të jetë e ftuara ime speciale çdo natë, një humoriste shumë e talentuar.



Nuk është hera e parë që modelja e njohur, tashmë në pritje të femijes së saj të dytë, poston foto e veshur me veshje popullore shqiptare. E shoqëruar edhe nga vogëlushja Ella Faria, ajo duket se është një nënë shumë e përkushtuar. Kohët e fundit modelja ka marrë me vete edhe Ellën në fotoshooting që ka bërë. Është hera e dytë që ajo përzgjedh të njohët botën me kulturën e veshjeve popullore shqiptare. Bukuroshja nga Mali i Zi shpesh herë shfaq në faqen e saj në "Instastory" edhe ushqimet tona apo kërcimet apo zakonet që ne kemi. Një ambasadore tepër e veçantë për Shqipërinë!

Emina shfaq foton e ëmbël të vajzës, veshur me kostum popullor shqiptar

Joni super i dashuruar, "E bukura dhe Bisha" në Disneyland me Merlin




Që nga momenti i shpalljes së fejesës e deri më sot nuk kanë të sosur rruet të udhëtimit dhe u pëlqen të shijojnë kohën e lirë nëpër vende të dukë përfshirë disa shtete të kontinentit verior si Boston, Massachusetts apo Rhode Island si edhe New York. Së fundi, ata kanë fluturuar për të qëndruar disa ditë në një nga shtetet e Disneyland siç është Hollywood. Dhe nuk mungojnë në fotot e postuara as dedikimet ndaj të fejuarës së tij. "E bukura dhe bisha" shkruhet në të fundit të postuar në "Instastory".



Pas gjithë këtyre diteve me shi, më në fund pak diell edhe në kryeqytet. Nuk ka ngurruar të shfrytëzojë rastin edhe modelja dhe ish-misi i njohur Suada Sherfi. Ajo ka preferuar t'i shijojë këto rreze duke dalë shëtitje me bukuroshen e vogël, Deizin. Një pasdite vërtetë e ëmbël për të dyja!

"Më në fund pak diell", Suada Sherfi poston foton më të dashur të pranverës

FOTO/ Pak nostalgji, Armina u rikthehet kujtimeve të adoleshencës



Nuk është e vetmja që kohët e fundit po ndihet paksa nostalgjike. Blogerja e njohur, Armina Mevlani mesa duket ka dashur t'i rikthehet fotove të 10 viteve më parë. Duke rikujtuar eksperiencat e mëparshme, Armina ka postuar disa foto ku dukej duke gatuar apo disa të tjera ku ka pozuar me vajzat e në Miss Bota 2010. Nga fotot duket se bukuroshja nuk ka ndryshuar aspak nga koha kur ka qenë vetëm 19 vjeç dhe shkante në palestër.





Si të luftojmë pagjumësinë dhe të flemë të qetë pa ilaçe?

Çdokush që vuan nga gjumi i keq, e di se po bën një jetë të mjerueshme. Dhe shifrat po rriten me shpejtësi. Sipas botimit të fundit të një ankete në Britani, më shumë se 51% prej nesh tani luftojnë për të fjetur të qetë natën, ndërkohë që gratë janë tri herë më të prekura se meshkujt. Provat e mbledhura nga 20.000 të rritur treguan se 93% e atyre që vuajnë nga pagjumësia raportojnë nivele të ulëta të energjisë dhe 83% ankohen për humor të keq. 77% e tyre kanë vështirësi në koncentrim dhe 64% thonë se janë më pak produktive në punë, ndërsa 55% thonë se kanë vështirësi në raport me marrëdhëniet. Por pasojat janë edhe më të rënda, gjumi i keq mund të rrisë rrezikun e zhvillimit të diabetit, duke përfshirë kushte depresioni, tension të lartë të gjakut dhe atak zemre. Kërkesit në Universitetin e British Columbia sugjerojnë se çdo orë e humbur e gjumit gjatë natës mund të na kushtojë një pikë IQ (koeficient inteligjence) të nesërmen. Shumica e njerëzve që vuajnë nga pagjumësia trajtohen me ilaçe, por shumë pilula kanë efekte anësore të padëshirueshme dhe rezultatet e studimit sugjerojnë se ato nuk zgjidhin problemet afatgjata të gjumit.

Pra, si mund të bëjmë diçka për të përmirësuar gjumin pa ilaçe? Colin Espie, profesor i psikologjisë klinike dhe drejtor i universitetit të qendrës "Glasgow Sleep", përqendrohet tek ajo që ai e quan "higjiena e gjumit": rutina e krevatit tonë dhe mjedisi fizik në të cilin ne përpiqemi të flemë. Espie beson se këta faktorë llogariten thjesht për 10% si zgjidhje e problemeve të gjumit. Por, shumica e ekspertëve pajtohen se vijimi i gjumit përbën një ndryshim. Drita

Një dhomë e errët është e rëndësishme për një gjumë të mirë. Gjithashtu, përpiquni të shmangni "të kaltrën e lehtë" më pak se dy orë para se të shtriheni në krevat. Hulumtimi nga qendra kërkimore sugjeron eliminimin e dritës nga tabletët, laptop dhe ekranet smartpone, pasi shumë prej personave ajo i duket si dritë e ditës dhe i mban zgjuar. Dhomat e gjumit duhet të ketë një temperaturë të rehatshme (rreth 18 gradë C), të qetë dhe të ventiluar mirë, me shtretër dhe jastëkë të rehatshëm.

Ushqim, pije, stërvitje
Çdo gjë që stimulon sistemin, të tilla si kafeina (edhe pse disa studime eksperimentale tregojnë se një filxhan kafë mund të zgjasë vetëm tri minuta kohën që rri zg-

juar), alkooli, çokollata, duhani, një vakt të rëndë apo stërvitje të lodhshme, do bëjë që momenti për të fjetur të vijë më vështirë. Synoni një dietë të rregullt, të balancuar dhe jo me teprime natën vonë.

Njëzet minuta në ditë ushtrime do sjellin një ndryshim të madh për gjumin, por jo para se të bini në shtrat.
"Gjumi borxh"
Sipas hulumtimeve në Universite-

tin e Teksasit, "gjumi borxh" pra koha e gjumit që shpesh marrim në fundjavë për aktivitete të tjera është mirë të "paguhet", por jo duke e tepruar. Tejzgjatja e orarit të gjumit rekomandohet vetëm në qoftë se ju jeni tepër të lodhur për të funksionuar.

Mosha
Rregullat dhe higjiena e gjumit vle-

jnë për të gjithë, por duhet të dini se në moshë të madhe ka më tepër vështirësi për të fjetur. Hulumtimet nga Universiteti Uashingtonit tregojnë se njerëzit e moshuar shpenzojnë më pak kohë në gjumë të thellë. Nëntëdhjetë për qind e betejës është në mendje dhe kjo është arsyeja pse terapia njohëse e sjelljes dhe terapia e të folurit po shihen tashmë si zgjidhje më të dobishme.



BULEVARDI

POLITIK

Rama përballet me "peshqit e mëdhenj" të qeverisë në Elbasan

Në kompleksin Rozafa në Elbasan, aty ku qeveria është zhvendosur për një mbledhje dy ditore, kryeministri Rama, por edhe ministrat janë përballur me një surprizë, ndoshta jo fort të këndshme.

Disa prej të pranishmëve thonë se kreu i ekzekutivit ka qeshur kur ka parë tabloun me "peshqit e mëdhenj" e me të në krye, të ideuar nga pronari i kompleksit,

Gjergj Luca. E pikërisht për këtë surprizë, Rama është ngacmuar edhe nga gazetarja e "News 24" Marsela Karapanço, të cilës vetëm për pyetjen që nuk iu përgjigj. Një ditë më parë keni lajmëruar arrestime të bujshme në "News 24" ku ishit për intervistë. Sot ndodhemi në këtë kompleks ku në një prej ambienteve kishte një karikaturë me disa peshq të mëdhenj që përbënin kabinetin qeveritar. A ishte surprizë për ju fakti që këta peshq të mëdhenj janë pikërisht ministrat e kabinetit tuaj qeveritar, z.Rama? "Unë nuk kam lajmëruar asnjë arrestim të bujshëm, se unë nuk lajmëroj arrestime pasi nuk kam detyrë të arrestoj njerëz. Kështu që kur të zgjoheni nga ëndrra ku më keni parë duke lajmëruar arrestime të bujshme, mund të bëhemi bashkë për një konferencë tjetër shtypi", -tha Rama.



Boçi i PD: Rama e mblodhi qeverinë te stabilimenti i peshkut

Deputeti demokrat i Elbasanit, Luçiano Boçi, komentoi dje mbledhjen e qeverisë që zhvillohet në këtë qytet. "Rama e ka mblodhur qeverinë në Elbasan te stabilimenti i peshkut, në Labinot, për t'u ndjerë "si në shtëpi të vet". D.m.th sipas një zhargoni që përdorej në Elbasan pas viteve '90, qeveria dhe Rama "po qërojnë koka peshku", si zakonisht. Ose me nuhatje e ka kuptuar që peshku i "është qelb nga koka" e vet. Ndoshta po kërkon aty "peshkun e madh" të munguar. Habitëm se si nuk e mblodhi qeverinë tek inceneratori. E ka simbol suksesi të koncesioneve, të aferave, korrupsionit, varferisë që ka mbjellë në Elbasan, e të kundërmosjes e helmimit të popullatës", shkruan Boçi në "Fb".



Jul Deda: Rama ua mbylli gojën artistëve dhe teatërdashësve me një plagjiaturë...

Aktori i njohur Julian Deda përmes shprehjet se kryeministri Edi Rama Aua mbylli gojën artistëve dhe teatërdashësve me një plagjiaturë. Një ditë më parë, Rama paraqiti projektin për teatrin e ri kombëtar, duke u shprehur se ai ishte një projekt i hartuar nga një prej arkitekteve më të mirë të arkitektures moderne. Por një ditë më pas, në rrjet janë publikuar foto dhe materiale, përmes të cilave hidhet dritë se projekti i paraqitur nga Rama është një projekt i vjedhur nga një studio ukrainase, i punuar në 2011 për Korenë e Jugut. "Të dashur kolegë aktorë, artistë dhe teatërdashës, Shikoni pak se me çfarë plagjiature jua mbylli gojën kryeministri. Jo vetëm që nuk ju pyeti fare, jo vetëm ju trajtoi si qenie të vogla, me të cilat ai mund të bejë dhe thotë ç'të dojë dhe si të dojë, por në fund ju la në derë një projekt të vjedhur nga një studio ukrainase të punuar në 2011-tën për Korenë e Jugut, si për të thënë se nuk ia vlen të lodhesh shumë për ju. Gjynah...!", - shkruan Julian Deda në "Fb".

Pozitat në Shkodër, këngëtarja Ndoci sulmon kreun e PD

Këngëtarja e njohur shkodrane, Rita Ndoci sulmon ashpër kreun e PD Lulzim Basha, i cili duhet thënë se ka dobësuar ndjeshëm pozitat e tij në Shkodër që me hartimin e listave të kandidatëve për zgjedhjet e 25 qershorit.

Ndoci, duke bërë krahasimin mes Bashës e Berishës thotë se ky i fundit u dha mundësi personalitetëve brenda së djathtës së bëheshin të tillë ndërsa kreu aktual i PD i zhduk "me një të rënë të lapsit". Ndoci e cilëson Bashën një "skuth" të mbushur "deri në fyt me skandale, ende pa ardhur në pushtet". Këtë reagim, këngëtarja shkodrane e ka bërë përmes një komenti në faqen e Murat Bashës, i cili hap diskutimin për të djathtën.



PROJEKTI

TEATRI I RI KOMBËTAR

Artistët: Si projekt korean, pikëpyetje për 'papionin'

Fatmira Nikollë

Projekti i arkitektit danez Bjarke Ingels për Teatrin e ri Kombëtar, prezantuar të hënën në Kryeministri, ka hasur në kundërshtimet e komunitetit artistik. Uniteti i fillimshkurit, i ka lënë vendin përçarjes mbi të ardhmen e godinës ekzistuese dhe nevojës për një teatër me kushte.

Të hënën, mes shumë artistëve të pranishëm në Kryeministri, vetëm Robert Ndrenika pati guximin të fliste hapur, publikisht kundër projektit që parasheh një godinë tri katesh me biznese brenda, që për t'u ndërtuar do t'i japë sipërmarrësve lejen për 6 godina afër saj. Ndonëse kryeministri tha se teatri nga 3 mijë metra bëhet 9 mijë metra (tashmë prej 3 kateve), artistët kanë 1 muaj që flasin për 6 mijë metra truall të teatrit, që më projektin e ri, i humb 3 mijë, të cilat duket se do të shërbejnë si 'pagesë' për ndërtimin e një godine me beton e xham. E denjë për shumë qytete të botës, pjesëtarë të komunitetit artistik, e gjejnë pa vend



Neritan Liçaj



Arben Derhemi

këtë godinë mes ansambllit të ministrive. Ajo që shihet 1 muaj më pas, janë aktorë të intimiduar që kanë frikë të dalin hapur e të kundërshtojnë një projekt që zhduk historinë, aktorë që ndihen të pafuqishëm për-

ballë qeverisë që nuk i pyet për asgjë dhe aktorë, që nuk kanë besim as te zëri i tyre.

KUNDËRSHTITË

Dje në Teatrin Kombëtar, anëtarë të sindikatës së artistëve u

mblodhën sot për të diskutuar rreth projektit. Duke qenë ende të paqartë se si do të jetë vijimi i protestës, për ata artistë që duan të mbrojnë godinën e tanishme të TK-së, mbledhja e djeshme shërbeu si këmbim mendimesh mes tyre.

Aktori Arben Derhemisgaroi se ishte "një mbledhje për të diskutuar për projektin e djeshëm. Ne që s'ishim, ne armiqtë e klasës. Pati urdhër nga drejtori që nuk na u lejua të hyjmë në godinën e TK. Dm.th. aty ku ne punojmë nuk lejohemi të hyjmë. Një projekt, i cili nuk ka lidhje me klasikun e TK. Me qelq e pamë TK, shiheshin aktorët se si visheshin, se si zhvisheshin, do të futen



nga poshtë kur t'i zërë shiu. U kënaqëm në".

Ndonëse kishte mes artistëve që e pëlqyen projektin, ata dolën kundër sjelljes së kryeministrit me artistët. "Përmes mediave pamë një shfaqje shumë të shëmtuar të kryeministrit, një tallje që ai bëri me të gjithë komunitetin tonë dhe një arrogancë të madhe", -tha Anila Bisha.


"Doketë reagim. Kryeministri bën kërcënimin e radhës. U mësuam me një kryeministër që del e shantazhon, pret koka, jep ultimatum, etj. U mësuam me të. Fakt është që kjo arroganca është e tepërt. Duhet të ndërrojmë stil. Njerëzit duhen parë në sy e duhen dëgjuar, jo të vendosë vetë për të gjitha. Për masat e protestës po bisedojmë se çfarë do bëjmë", tha Liçaj.

Pas Robert Ndrenikës që pati guximin ta bënte publik qëndrimin e tij në Kryeministri, edhe pse në kohën që doli ai, u ndërpre transmetimi direkt, edhe artistët të tjerë e kundërshtuan partneritetin publik privat, për ndërtimin e Teatrit të ri Kombëtar.

Neritan Liçaj tha se "nga televizori, nuk kuptova shumë. Do ishte mirë që ta kisha parë atje, po nuk



Projekti për operan koreane



Projekti për teatrin shqiptar

DO E DORËZONI TESERËN E PS? FUGA: TË MBAROJË EDHE LUFTA E IDEALIT...

FATMIRA NIKOLLI

Genci Fuga prej kohësh është anëtar i Partisë Socialiste. Ai e mori taserën në një nga takimet që transmetoheshin drejtpërdrejt të kryeministrit, jo pa batuta. Kohë më vonë, raportiti i tij me PS-në, nuk duket i njëjti. Fuga, ishte një prej zërave kundërshtarë sa i takon ligjit të ri për artin dhe kalimit të trupës së aktorëve nga godina e TK-së në qendër, tek ambientet e Turbinës. 1 muaj më vonë, ai është kandidat për drejtor i Teatrit Kombëtar, e me gjithë sa më lart, në takimin e ditës së hënë ku artistët qenë thirrur për t'u prezantuar projektin e godinës së re të TK-së, Fuga, nuk u thirr. Në fund të fundit, nuk qenë thirrur as zëra të tjerë kundërshtarë, si Kastriot Çipi apo Arben Derhemi, por Fuga vjen nga partia që ka formuar qeverinë.

I pyetur dje se ç'mendim ka për projektin, ai tha se "e kam ndjekur prezantimin, nëpërmjet



Genci Fuga

medias, sepse s'kam qenë pjesë e protokollit të kryeministrit dhe të Ministrisë së Kulturës, për organizimin e këtij takimi. Unë kam 25% probabilitet të jem drejtues i teatrit dhe më erdhi keq për këtë mosvëmendje. Projekti mu duk i kënd-

shëm, por mungojnë të gjitha ambientet ndihmëse të një skenë të caktuar".

Nga ana tjetër, Genci Fuga, shtoi se nuk e dinte se si do ishte qëndrimi i tij si aktor "nisur nga fjalja patjetër me humor e arkitektit kur tha: ne mund të shohim paskenën apo momentin ku aktorët hyjnë në skenë, madje duke parë e përshëndetur ata njerëz që kalojnë në pedonale. Ky sipas meje, është një moment që mbetet intim me aktorin, se lind një karakter".

I pyetur nëse godina e prezantuar është e përshtatshme për një teatër kombëtar, Genci Fuga tha: "Prof.(Artan)Fuga, që unë kam xhan dhe familjar, thotë ha, debat. Mos kërkoni opinionë".

I pyetur nëse si formë proteste, artistët do lënë shfaqjet, do bëjnë

grevë apo do të mbajnë çfarëdo lloji organizimi tjetër kundërshtues ndaj projektit, ai tha se nuk kanë një strategji të qartë.

Më pas, "GSH", këmbënguli të dijë, të ardhmen e raporteve të tij me PS. Pyetjes nëse pas gjithë kësaj që ka ndodhur, a do ta dorëzojë ai taserën e partisë, Fuga iu përgjigj: "Nuk mendoj që është ky diskutimi. Jam futur për një ideal të caktuar. Të mbarojë edhe lufta e idealit, pastaj pse jo. Por të shpëtoj të gjitha mjetet e mia personale të luftës".

I pyetur nga gazetarët nëse është zhgënjyer, Fuga tha se nuk do ta thoshte këtë.

Më pas, "GSH" këmbënguli të dinte nëse pas faktit që "Partia ku ju aderoni nuk ju mbështet idetë tuaja mbi teatrit; pas faktit që qeveria e krijuar prej kësaj partie, nuk ju thërret në një prezantim për projektin e një teatri ku ju synoni të jeni drejtor", cili është qëndrimi juaj, Genci Fuga do t'i

përgjigjej kështu: "Të thashë lexoj shumë. Di të bëj dallimin mes një qeverie të caktuar, partisë dhe funksioneve të veta, ndërmjet politikave afatmesme e afatgjata të origjinuara nga një forcë e caktuar politike. Në këtë mes, do shoh sektorin tim të kulturës dhe jam duke e ndjekur sektorin tim të kulturës, duke mos qenë kompetent për gjithçka. Në këtë mes përfituesi është qenia ime brenda Partisë Socialiste".

I pyetur sërish nga "GSH", nëse po lobon për të mirën e teatrit, Fuga tha: "Nuk po loboj për të mirën vetëm të teatrit, unë jam një person i lidhur mbi skenën, më falni po është ndërhyrje. Po loboj për veten, për të pasur një hapësirë shumë herë më të mirë, për të pasur një hapësirë jo të rrezikshme për shëndetin e për jetën, për të pasur para më tepër për t'u ballafaquar me vajzat e mia në darkë. Këto janë lëvizje të një personi anëtar të PS dhe njëkohësisht të një pedagogu, aktori e regjisorit".

AKTIVITETI

Fatmira Nikolli

FESTIVALI PËR LETËRSINË PËR FËMIJË

Petrit Ymeri: Nuk ka shkrimtarë të rinj që e lëvrojnë

"Kemi mbetur te Gaqo Bushaka e Adelina Mamaqi, të rinjtë ndjekin shkolla shkrimtarie"

Xhevahir Spahiu, pasi kishte shkruar disa poezi, nga ato që mbeten në mendje gjatë dhe i kujton edhe kur rritesh, shkruante: "E pra, vogëlushë, më e drejtë do të ishte të thosha: këto vjersha i kemi shkruar së bashku. Po meqenëse shkonte gjatë, shpejtova të vë emrin tim. Pastaj, ç'rëndësi ka se të kujt janë. Mjaft që të jenë të bukura dhe t'i falin njeriut gëzim." Me shembullin e Spahiut u hap dje në Tiranë konferenca kushtuar Festivalit për Fëmijë dhe të Rinj.

Nën moton "Të gjithë librat janë të rëndësishëm" në Muzeun Historik Kombëtar ku do të mbahet festivali, organizatori Petrit Ymeri tha se libri për fëmijë dhe të rinj është element thelbësor për përmirësimin kulturor të shoqërisë.

Për 3 ditë me radhë, libri për këtë grupmoshë do të jetë kryefjala e një sërë aktivitetesh që do të organizohen në MHK nga shtëpia botuese "Dituria", me anë të projektit Creative Europe. Qëllimi kryesor i këtij festivali është promovimi i lexuesit të së ardhmes.

Botuesi Petrit Ymeri tha se do të ketë aktivitete me përkythes, laboratorë e seminare. Ai shtoi edhe se është punuar për të kuptuar se ku qëndrojnë problemet me letërsinë për fëmijë në Shqipëri.

"Kemi bërë anketim për leximin, tendencat, prirjet, dukuritë. Ne nuk kemi bërë se çfarë mbështetje japin. Nuk është se ke të dhëna. Ne do t'i japim lexuesit më të mirë në qilin që ka. Nuk ka rëndësi kush janë autorët. Megjithëse problemi ynë është se për letërsinë shqiptare për fëmijëve, kemi vetëm autorë të vjetër. Kemi mbetur ende te Gaqo Bushaka e Adelina Mamaqi. Nga një anë kjo është një gjë e mirë se janë autorë të konsoliduar, por nga ana tjetër, është gjë e keqe, sepse janë tematika të vjetra", tha Ymeri. I pyetur nga se çfarë mund të bëhet dhe çfarë duhet bërë për të nxitur interesin në lëvrimin i kësaj letërsie, Ymeri tha se "shkrimtari duhet të punojë vetë për t'u përmirësuar



Konferenca e djeshme

dhe se duhet të jetë njeri i bredhur, i shtetit, i formuar dhe i kulturuar".

Sipas tij, ka disa elemente të reja që mund të bëhen shkrimtarë të mirë për fëmijë, por sipas tij, ata duhet të ndjekin kurse shkrimtari dhe duhet të punojnë fort, sepse të shkruash një vepër nuk është aq e lehtë.

"Ka shumë shtëpi botuese që botojnë në nivele të mira të kësaj letërsie. Shpesh kanë qenë projektet europiane që e kanë nxitur këtë letërsi, por janë botuar autorë nga Europa. Shkrimtarët shqiptarë të rinj, duhet të investojnë te vetja. Duhet të studiojnë e të shohin. Të investojnë se duhet të kesh kulturë që të shkruash", tha Ymeri.

Ai tha edhe që s'është detyrë e shtëpive botuese të zbulojnë talentet të reja.

Shtoi se letërsia origjinale për fëmijë s'ka fituar mbështetje, sepse nuk ka. "Letërsia shqipe nuk krahasohet me nivelet europiane, por mund të them se vitet e fundit shoh autorë shqiptarë për t'u vlerësuar, sepse është tejkaluar koha e hezitimit për emrat shqiptarë. Ky kapërcim duhet të bëhet edhe për letërsinë për fëmijë. Ne do i mbështesim duke i botuar. Ka disa emra që mund të bëhen, por duhet të punojnë. Ka shkolla shkrimtarie që duhen ndjekur dhe Creative Europe ka disa projekte për këtë çështje", shtoi Ymeri.

"Lapsat mpërhu" për shkrimin më të bukur është takimi që mbahet për të kuptuar vlerat e leximit dhe shkrimit! Një shkrimtare dhe një përkythëse do të përcaktojnë disa rregulla të thjeshta duke dhënë edhe këshilla për për-

dorimin e saktë të fjalëve, parqitjen e emocioneve, këndvështrimin e secilit. Pastaj do të lexojnë një fragment të zgjedhur nga letërsia për fëmijë. Dhe nxënësit që do të "ndeshen" mes tyre me "Lapsat e mpërhu mirë", në një takim drejtuar nga Klara Kodra dhe Albana Nexhipi.

Laboratori krijues i Festivalit për Fëmijë dhe të Rinj mban moton "Aroma e librave... Po ju lexoni librin elektronik apo iPad?" Vihen përballë libri elektronik dhe libri "tradicional", i shtypur në letër, megjithëse festivali synon të thotë se leximi i një libri letre ose një ebook-u nuk është e njëjta gjë, edhe nëse përmbajtja është po ajo, në takim do të jenë Edmond Tupe e Pandeli Koçi.

Promovimi i librit dhe përkthimit të mirë, diskutimi për vështrirësitë dhe vënia e disa standardeve, është qëllimi seminarit që mbahet në festival. Duke qenë se është e zakonshme që përkthyesi të përshkruhet si një ndërmjetës, si ai që lehtëson dialogun ndërmjet tekstit "burimor" dhe audiencës së synuar, seminari synon t'u japë përgjigje pyetjeve "si përkthet? Çfarë bën përkthyesi për të kapur" siç duhet zërin e shkrimtarit nga një gjuhë tjetër? Ç'do të thotë të përkthesh për adreloshentë në një botë dixhitale? Çfarë lexojnë fëmijët sot? Si e shohin botën përmes librave?"

Nga data 16 deri më 18 do të mbahen një sërë aktivitetesh, ku në fokus është leximi, promovimi i letërsisë për fëmijë, debatet rreth librit, ekspozita dhe teatrit. Për herë të parë do të ketë edhe një statistikë të dalë nga rezultatet e një anketimi të përbashkët për leximin në Shqipëri, Itali, Maqedoni, ku do të pasqyrohen diferencat, analogjitë dhe perspektivat.

8 added new photos Postimi i Kastriot Çipi

it danez apo paljaçatë e pushtetit? Projekti i Ramës për një studiо ukrainase Forma, fitues i çmimit të tretë në konkursin për Operan e Busanit në Korenë e Jugut, ykoni vetet



ka rëndësi. Shumë mirë bënë që s'më thirrën, e panë kolegët e mi e shumë mirë bënë që shkuan në prezantim. Nuk kam asnjë kundërshtim. Mirë është të tregohet projektet, se deri tani jemi mbajtur pak në mjegull, me deklarata e kundërdeklarata. Më shumë se same projektin dua të merrem pak me këtë filozofinë e tre P-ve që na është kthyer gogol në Shqipëri. Partneriteti publik privat, dhe singerisht habitem pse duhet të jetë kudo. Nuk jam kundër po pse duhet të jetë kudo? Pse duhen futur gofte në Butrint, pse duhet prishur teatri dhe i duhet dhënë biznesit disa metra? Tek institucionet kombëtare duhet të jesh ti si shtet. Te Stadiumi Kombëtar, te Teatri Kombëtar, te Opera Kombëtare, te Galeria Kombëtare, te Biblioteka Kombëtare. Sepse qeveritarët për veten kanë para për udhëtime në klas të parë e më gjerë, por jo për institucionet. Po pse kur vjen puna të arti e kultura nuk ka lekë, mua kjo më shqetëson".

Duke rivënë theksin te humbja e truallit, Liçaj shtoi se kjo është dheqerisje e majtë dhe kryeministri duhet të jetë më pranë qytetarëve jo pranë biznesit siç po bën. Madje bën mirë që rri pranë biznesit, por jo vetëm për biznesin.

PLAGJIATURË?

Isht-drejtori i teatrit Eksperimental, Kastriot Çipi, përmes një postimi në rrjetin social "Facebook" ka ngritur pyetjen se a është plagjiaturë e arkitektit danez apo paljaçatë e pushtetit?

Çipi ka shkruar se projekti i Ramës për TK është, në fakt, projekti i studios ukrainase "Forma", fitues i çmimit të tretë (pra i skuallifikuar) në konkursin për Operan e Busanit në Korenë e Jugut.

10 VJET TEATRI 'METROPOL'

PEMËT NUK RRITEN NËSE NUK I RREH FURTUNA

NGA KIÇO LONDO

Nuk e di pse kjo shprehje e Niçes më vjen ndër mend në këtë fillim pranvere. Në këtë muaj të dashur, i cili më bën nostalgjik e më kthen dhjetë vite më parë, ku fati më çoi në atë ndërtesë të shenjtë, dikur me emrin "Variete e Tiranës".

Në atë ambient artistik unë kisha përjetuar çaste të paharruara si student. Ishte ajo kohë kur një shfaqje e "Varietes së Tiranës" eklipsonte çdo ngjarje tjetër kulturore në kryeqytet. Por, kjo kishte kohë që nuk ndodhte më, e megjithatë në atë ndërtesë të rrruar vazhdonin të rezononin tingujt e zërit të Vaçe Zelës, Pavlina



Nikës, Anita Takes, Ema Qazimit, Liljana Kondakçiu, Irma Libohovës, Luan Zhegut, Kozma Dushit, etj, humori brilant i Ramazan Zyberit, Skënder Sallakaut, Vasil- laq Vangjelit, Agim Bajkos, Xhevahir Zenelit, Marjana Kondit, Vegim Xhanit, Kosta Kamberit,

etj. Nuk jam në gjendje ta shpreh me fjalë se sa shumë më magjepste ai ambient, sa shumë më frymëzonte dhe një fuqi e misterhme më tundonte të luftoja për ta shpëtuar këtë godinë e për të themeluar Teatrin e Metropolit që sot mbush 10 vjet.

Por, ky nuk është një triumf personal, është një përpjekje e vazhdueshme e një brezi aktorësh të edukuar për të çmuar vlerat dhe për mos t'i harruar ato. Ky teater i ri ngjalli tek të rinjtë një ambicie të lartë. Të gjithë filluan të zbulonin tek vet-

ja një talent, një ëndërr dhe krijuan kështu gjenërat e re të artistëve të apasionuar pas teatrit. E kjo teatërmani u kthye në epidemi. Por jemi larg detyrës së përbashkët aktorë - spektatorë për ta bërë teatrin një nevojë jetike për shoqërinë. E kur t'ia arrijmë këtij qëllimi final mund të themi pa frikë se Shqipëria po ndryshon. Kemi ecur përpara, jemi bërë njerëz më të mirë. E kjo sfidë e madhe kërkon sakrificë në kohë e vështira që po jetojmë.

Dhe në këtë "furtunë" pranvere, ku historia e teatrit mban frymën, më vjen ndër mend shprehja: "Për çdo hap në dritë paguhet taksa e hijes dhe për çdo hap në errësirë paguhet gjithë mungesa e dritës".

Dje në 'Deutsche Welle'

Greqi, nga afendikonj, në punëtorë krahu

Nga Anthe Carasava



(Vijon nga faqja e parë)

... të tre fëmijëve të regjistruhet në radhët e të papunëve, një numër që në Greqi është më i madhi mes 28 vendeve të Bashkimit Evropian.

Muajt në vijim pasuan herë me punë e herë pa punë. Por kërkimi i një pune të përhershme në Greqinë e mbytur nga kriza më e madhe financiare, që mund të ketë goditur ndonjë vend të Bashkimit Evropian, ishte e kotë.

Kështu i joshur nga një shok, po ashtu i papunë, si dhe reklama e shkëlqyer që premtonte të ardhura deri 1.300 euro në

muaj, Varthimiadisi firmosi kontratën me një agjenci greke që rekrutonte punëtorë lokalë për një fabrikë japoneze në Republikën Çeke. Kushtet e punës në fabrikën që ndodhet në Kadan, rreth 90 km në verilindje të Pragës, dukeshin shumë të mira, por konfiguracioni i kontratës ishte mashtrim.

REALITETI NË TERREN

"Sa shkuam atje," tregon Varthimiadis, "përfaqësuesit e shërbimit të rekrutimit na vunë përpara një kontratë, në të cilën shkruheshin gjëra krejt të tjera: rroga mujore ishte 540 euro, pa pagesë për orët jashtë orarit ose

përfitime të tjera që na ishin premtuar."

Ish-bukëpjekësi dhe shoku i tij refuzuan të firmosnin dhe u kthyen menjëherë në Greqi. Por të tjerët, pjesa më e madhe të rinj që po konfrontohen me papunësinë 50 përqind të lartë në vend, qëndruan.

"Që në minutën kur hipëm në autobusin e rrënuar për të bërë udhëtimin 40 orë deri në Kadan, u duk qartë se kishim të bënim me një mashtrim"-i tregon Deutsche Welles Christina Neri. "Por kur është i dëshpëruar njeriu ka tendencën të mos shikojë shumë gjëra."

EMIGRIM MASIV

Rreth 55 mijë agjenci në gjithë Evropën rekrutojnë çdo vit qindra mijëra punëtorë për punë krahu dhe punë në sektorin e shërbimit. Agjencitë u mundësojnë punëdhënësve të marrin punëtorë më fleksibël për të kursyer kostot gjigande të punës.

Më shumë se 427,000 grekë janë larguar nga Greqia për të kërkuar punë jashtë vendit, që kur ekonomia pësoi kolaps në vitin 2009. Truri i vendit po largohet, shkruan Banka Greke. Niveli i emigrimit e rendit Greqinë në vendin e tretë pas Qipros dhe Spanjës, sa u përket shifrave të të rinjve që largohen nga vendi.

HOROSKOPI

DASHI

Do të jeni të suksesshëm në shkollë dhe në punë. Ndoshta në të vërtetë ndiheni të pakënaqur, por kur ke fantazi e tejkalon mërzhikun Venusi plot gjallëri, gjatë ditës ju mbështet ëmbëlsisht ëndrrat dhe dëshirat, ndërsa në mbrëmje ju sjell me këmbë në tokë.

DEMI

Do të jeni me miq dashamirës dhe përkrahës, me të cilët do të vendosni të organizoni një shtëpi të bukur. Mes artit dhe natyrës, të bashkëpunues është edhe më e lehtë. Shpenzime të paparashikuara në punë: kompjuteri dhe printeri kanë nevojë për ndërrhytjen e një tekniku.

BINJAKET

Kjo ditë do t'ju shërbejë për të cimentuar një lidhje të konsoliduar ose të shkrijë ndrojtjen në një marrëdhënie të porsalindur. Në punë do t'ju duhet të pranoni disa kompromise: solidariteti është i barasvlerëshëm me suksesin e ndërmarrjeve.

GAFORJA

Në dashuri do të tregoheni pak posesiv si edhe do të ndikoheni nga kritikë dhe pakënaqësitë në familje. Jeni të qetë vetëm miq, që të ju mundësojnë ekuilibër. Do të keni disa shpenzime të mëdha për shtëpinë: bëhet fjalë për punime mirëmbajtjeje.

LUANI

Do të mbizotërojë shpirti i skuadrës me kolegët, kur njëri nuk ia del e ndihmon tjetri, pa zili dhe kritika, për të arritur objektivin. Investimet do të duhet të monitorohen: konsultohuni me një ekspert të kësaj fushe. Do të bëni bërje interesante në librarë.

VIRGJERESHA

Në kontakt me publikun jeni gjithmonë të preferuar, buzëqeshja juaj lehtëson barrën dhe shkrin pakënaqësitë e atyre që janë në pritje. Do të kaloni një mbrëmje shumë të bukur dhe argëtuese në shtëpinë e miqve të juaj.

PESHORJA

Është dita ideale për ata që kanë dëshirë të bëjnë punime: në shtëpi keni me të vërtetë shumë punë për të bërë. Mjetet dhe materialet do të jenë të kushtueshme, por do t'ia vlejë. Edhe në zyrë atmosfera është e qetë, të gjithë mendojnë për punën e tyre pa ndërhyrë në atë të tjerëve.

AKREPI

Do të keni krijimtari të rafinuar. Arti, fotografia dhe muzika nuk janë thjesht hobi, por mund të kthen mundësi profesioni. Planetët bashkëveprojnë për t'ju mbështetur. Do të keni shumë energji, pasion dhe besim në aftësitë e juaj krijuese.

SHIGJETARI

Mërkuri miqësor në bashkëveprim me Neptunin, krijonë situatën ideale për të bërë paqe me partnerin, nëse do të ishte e nevojshme, dhe të t'i ktheni përsëri buzëqeshjen njëri-tjetrit. Ndërkaq, është thelbësore që të përballeni gjithmonë me të vërtetën.

BRICJAPI

Mërkuri miqësor në bashkëveprim me Neptunin, krijonë situatën ideale për të bërë paqe me partnerin, nëse do të ishte e nevojshme, dhe të t'i ktheni përsëri buzëqeshjen njëri-tjetrit. Ndërkaq, është thelbësore që të përballeni gjithmonë me të vërtetën.

UJORI

Hëna ju bën të ndiheni të sigurt. Do të shfaqni prova të mëdha të miqësisë dhe idealit të përbashkëta me të njohurit. Do të tregoni gatishmëri drejt një kolegu, i cili po kalon nëpër një fazë të vështirë. E dini që vepra do t'ju shpërblehet.

PESHQIT

Me mendjen e turbullt, mes fantazive të parralizueshme dhe projekteve të cunguara. Nëse kërkoni gjëra, dhe është mirë që e bëni, mbështetja nuk do t'ju mungojë. Ajo që mungon sot është në veçanti dëshira për të hyrë në lojë, duke shfrytëzuar kapacitetet e juaja.

Opinion i Ditës

Nga Dritan Hila

Një kërkesë Artan Lames, Artan Shkrelit dhe Auron Tares

(Vijon nga faja e parë)

... sot për shkak të funksioneve shetërore janë të heshtur. Janë të mirëkuptuar.

Jo sepse nuk janë të mirëpritur protestuesit, por sot ata nuk bëjnë punë, sepse Rama ka shumë më tepër vota nga sa i duhet të qeverisë, presidenti i pafuqishëm dhe gjykata e terrorizuar, ndaj mund t'iu priste kollaj kokën.

Nuk janë të paragjykuar as pse punojnë në shtet. Në një vizitë të tij në Ermitazh në kohën kur ishte ambasador në Moskë në periudhën kur ende nuk kishte rënë komunizmi, Serxhio Romanos i bën përshtypje klasi i ciceronit. E pyet për origjinin dhe mikpritësi i thotë se ishte pinjoll kontësh, i vetmi i mbetur pa pushkatuar nga familja e tij. Romano mbetet i habitur dhe e pyet si ia bën që u shërbent komunistëve. Dhe përgjigja e kontit ishte: Zotëri, nëse do iu shityte familjen treni, ju nuk do të hipnit më në tren?

E sjell këtë për të hequr mitin se të gjithë ata që punojnë në shtet janë bashkëpunëtorë të shefit të qeverisë. Madje, në raste si ai i Ramës kur kontrollon të gjitha pushtetet, tre zotërinjtë janë të vetmit që mund t'i flasin dhe kërkojnë që të ndalë vrullin për prishjen e Teatrit Kombëtar.

Këta janë jo vetëm miq të Ramës, por edhe njerëz që e dinë se çfarë është trashëgimia kulturore; e dinë se zëvendësimi nga një ndërtesë qoftë më moderne dhe e madhe e ndërtesës ekzistuese, i heq një kujtim dhe pikë referimi kryeqytetit, e cila godinë është më shumë sesa objekt ku jepen shfaqje dhe punësohen artistë.

Me siguri e dinë rastin që kur në parlamentin italian po diskutohet kthimi i Kokës së Deas së Butrintit i marrë nga Ugolini dhe mbrojtësi i rikthimit argumentoi se ishte pjesë e trashëgimisë sonë kulturore, një deputet i MSI (neofashistët) iu kthye me britma se në bregun përballë kishin vetëm një tufë njerëzish të egër dhe paqytetëruar, ndërtesat e vetme të së cilëve i kishin bërë fashistët. E dhimbshme, por pjesërisht e vërtetë. Sepse hiq qendrat e disa qyteteve të stilit oriental, të cilat nuk ekzistojnë më, të vet-



met që na kanë mbetur janë godinat e ministrive dhe disa të tjera që numërohen me gishtat e dorës.

Personalisht shpresoj që do ta bëjnë kryeministrin t'i thërrasë mendjes. Dikur Albert Speer, arkitekti i preferuar i Hitlerit dhe beniamin i tij, theu urdhrin e

dhënë nga shefi i nazistëve për të rrafshuar me tokën qytete gjermane për të ndalur ofensivën ruse. Rrezikoi kokën e tij, por nuk shkatërroi edhe atë pak që kishte mbetur nga Gjermania. Ndërsa në rastin tonë kemi rrafshuar stadiumin kombëtar, shkollën "Kosova", kopshtin "Shtatë Xhuxhat

dhe tani teatrin. Nuk na mbetet shumë si dëshmi se kemi ekzistuar para vitit '45.

Ndaj dy Artanët dhe Auron mund t'i thonë një fjalë, mund t'i rikujtojnë sa e ndihmuar të diskreditonte Berishën dhe të vinte në pushtet. E kanë për detyrë ta bëjnë, pasi kanë mobilizuar opin-

ionin edhe për një shatërvan alçje. Duhet t'i kërkojnë që të mos i vejë kazmën një ndërtese, ku ende janë hijet e yjeve të skenës shqiptare, e cila mesa duket do t'i duhen dekada të ketë aktorë të të njëjtit kalibër. Të paktën të mbetet tempulli i tyre.

"Dritare.net"

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE
MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE
DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



KESTI I DYTE / Publikohet lista me dokumentet që duhet të plotësojnë përfituesit

Ish-të përndjekurit, dokumentet për 2 mijë trashëgimtarë

Ministria e Financave: Plotësoni dosjet brenda muajit

Ornela Manjani

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë, fëmijët dhe nipërit duhet të plotësojnë dokumentet brenda muajit për të marrë dëmshpërblimin në momentin që Ministria e Financave do të çelë fondin për pagesa. Rreth 2 mijë trashëgimtarë ligjorë të ish-të dënuarve politikë duhet të plotësojnë dokumentacionin në bazë të kategorisë ku përfshihen sipas përcaktimeve ligjore. Ministria e Financave bën të ditur se çdo trashëgimtar ligjor, që është listuar në një prej kategorive për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë, duhet të postojë dokumentacionin e kërkuar.

PËRFITUESIT QË JETOJNË

Për trashëgimtarët e ish-të përndjekurve që jetojnë në vendet e huaja, duhet të plotësojnë akt trashëgimie, certifikatë vdekjeje të të dënuarit, certifikatë trungrug të të dënuarit, numër llogarie bankare aktive për çdo përfitues ose prokure dhe dokument identifikimi për përfituesit. Në qoftë se njëri ose disa trashëgimtarë të radhës së dytë nuk jetojnë më, e drejta e tyre për dëmshpërblim në bazë të ligjit Nr.9831, datë 12.11.2007 (ndryshuar me ligjin nr. 10 111, datë 2.4.2009) nuk vazhdon më tej. Në këtë rast, llogaritja e pjesës takuese të kështit bëhet mbi bazën e trashëgimtarëve

që janë gjallë. Nga ana e trashëgimtarëve që jetojnë, në marrëveshje, paraqesin certifikatën e vdekjes së trashëgimtarit që nuk jeton, të cilën e postojnë së bashku me numrin e dosjes. Ministria e Financave bën të ditur se në rastet kur ish-i përndjekuri nuk jeton më, një dosje quhet e rregullt dhe e gatshme për t'u paguar, vetëm atëherë kur të gjithë trashëgimtarët, pa përjashtim, do të kenë dorëzuar (postuar) dokumentacionin e përmendur më lart për të gjitha rastet e trashëgimisë. Në të kundërt, askush nuk mund të paguhet i veçantë, derisa i gjithë dokumentacioni i dosjes të jetë i plotë për të gjithë.

TRASHËGIMTARËT


- Për persona ish-të dënuar që janë gjallë, të cilët pavarësisht moshës, në momentin e pagesës kanë fëmijë të mitur nën moshën 18 vjeç:
 - Certifikatë personale jo më e vjetër se një javë nga data e dorëzimit.
 - Certifikatë familjare ku të përfshihet fëmija i mitur.
 - Certifikatë personale të fëmijës/fëmijëve të mitur.
 - Nr. llogarie bankare në Lek në njërin nga bankat e nivelit të dytë, që vepron brenda territorit të Republikës së Shqipërisë (të siguroheni që llogaria është ende aktive ose të hapet një llogari e re).
- Për persona ish-të dënuar që nuk jetojnë, por në momentin e pagesës kanë trashëgimtarë të radhës së parë në moshë të mitur nën 18 vjeç.
 - Certifikatë vdekjeje të personit ish-të dënuar.
 - Certifikatë personale e të miturit/miturve, trashëgimtarë të radhës së parë të personit ish-të dënuar që nuk jeton më.
 - Certifikatë familjare të ish-të dënuarit ku të përfshihen fëmija/fëmijët e mitur.
 - Dëshmi trashëgimie që të vërtetojë se fëmija i mitur është trashëgimtar ligjor.
 - Vendim gjykatë të kujdestarisë mbi të miturin në rastin kur edhe nëna e të miturit nuk jeton më.
 - Nr. llogarie bankare në Lek në njërin nga bankat e nivelit të dytë që vepron brenda territorit të Republikës së Shqipërisë (të siguroheni që llogaria është ende aktive ose të hapet një llogari e re) në emër të kujdestarit ligjor të të miturit.

| Emër | MBIEMER | Emër | MBIEMER | KOPJE TE LETER NJOFTIM | NUMER PERSONAL LLOGARI BANKARE | CERTIFIKATE VDEKJE | CERTIFIKATE TRUNGRUG FAMILJAR | DESHMI TRASHGIMIE | PROKURE |
|------------------------------------|------------------|------|---------|------------------------|--------------------------------|--------------------|-------------------------------|-------------------|---------|
| (Vijon nga numri i djeshëm) | | | | | | | | | |
| | | | PASHO | V | | | | | P |
| | | | PASHO | V | | | | | P |
| | | | PASHO | V | V | | | | V |
| | | | PASHO | V | | | | | P |
| | | | PASHO | V | | | | | P |
| SADI | SULLARI | | | | | V | V | V | |
| | | | SADI | V | | | | | P1 |
| | | | SADI | V | | | | | P1 |
| | | | SADI | V | | | | | P1 |
| | | | SADI | V | | V | | | P1 |
| | | | SADI | V | V | | | | VI |
| PRENG | BUKAGJINI | | | | | V | V | V | |
| NIKOLL | BUKAGJINI | | | | | V | V | V | |
| PJETER | BUKAGJINI | | | | | V | V | V | |
| | | | PJETER | X | V | | | | |
| | | | PJETER | V | V | | | | |
| | | | PJETER | V | V | | | | |
| DILE | DUKAJ | | | | | V | V | V | |
| | | | ILLESH | V | V | | | | |
| | | | ILLESH | V | V | | | | |
| ALI | KORA | | | | | V | V | X | |
| | | | ALI | | | | | | |
| | | | | | | V | V | V | |
| ALMA | ZADEJA | | | V | V | | | | |
| GEZIM | RADOVICKA | | | V | V | | | | |
| GAZMEND | RADOVICKA | | | V | V | | | | |
| | | | | | | V | V | V | |
| MARK | BIERGJII/CIMA | | | V | V | | | | V |
| NDUE | BIERGJII/CIMA | | | V | V | | | | |
| MARIE | KUMBULLA (CIMA) | | | V | | | | | P |
| KATRINA(E) | | | | V | | | | | |
| | LULGIURAJ (CIMA) | | | | | | | | P |
| KOL | BIERGJII/CIMA | | | | | V | V | V | |
| | | | KOL | V | | | | | P1 |
| | | | KOL | V | V | | | | VI/KC |
| | | | KOL | V | | | | | |
| | | | KOL | V | | | | | |
| | | | KOL | V | | | | | |
| | | | KOL | V | | | | | |
| NIKOLL | BIERGJII/CIMA | | | | | V | V | V | |
| | | | NIKOLL | V | V | | | | |
| | | | NIKOLL | V | V | | | | |
| | | | NIKOLL | V | V | | | | |
| | | | NIKOLL | V | V | | | | |
| SARTABE | HOKHAJ | | | | | V | V | V | |
| BAUL | HOKHAJ | | | | | V | V | V | |
| | | | BALL | V | X | | | | |
| | | | BALL | V | X | | | | |
| | | | BALL | V | X | | | | |
| CAJUP | HOKHAJ | | | V | V | | | | |
| LAVDOSH | HOKHAJ | | | V | V | | | | |
| VEIS | HOKHAJ | | | V | V | | | | |

| Emër | MBIEMER | Emër | MBIEMER | KOPJE TE LETER NJOFTIM | NUMER PERSONAL LLOGARI BANKARE | CERTIFIKATE VDEKJE | CERTIFIKATE TRUNGRUG FAMILJAR | DESHMI TRASHGIMIE | PROKURE |
|---------|----------------|------|---------|------------------------|--------------------------------|--------------------|-------------------------------|-------------------|---------|
| HAZBIE | HOKHAJ | | | V | V | | | | |
| IDRIZ | HOKHAJ | | | V | V | | | | |
| ARBEN | HOKHAJ | | | V | V | | V | V | |
| DEJE | SALLA | | | V | | | | | P |
| OSMAN | SALLA | | | V | V | | | | V |
| NESHAT | SALLA | | | V | | | | | P |
| ANDREA | SALLA | | | V | | | | | P |
| LEME | QEVAN | | | | | V | V | V | |
| | | | FIQIRI | V | | | | | P |
| | | | FIQIRI | V | | | | | P |
| | | | FIQIRI | V | | | | | P |
| | | | FIQIRI | V | | | | | P |
| | | | FIQIRI | V | | | | | P |
| | | | FIQIRI | V | | | | | P |
| REFAT | SALLA | | | V | | | | | P |
| DILA | DUKAJ | | | | | V | V | V | |
| GJERGJ | DUKAJ | | | V | V | | | | |
| DED | DUKAJ | | | | | D | | | P |
| | | | | | | D | | | P |
| | | | | | | D | | | P |
| | | | | | | D | | | P |
| | | | | | | D | V | | V |
| | | | | | | D | | | P |
| | | | | | | D | | | P |
| | | | | | | D | | | P |
| LOKE | SAHITI | | | | | V | V | V | |
| HAMIDIE | SAHITI | | | | | V | V | V | |
| HASAN | SATILMANOVI | | | V | V | | | | |
| ISUF | MANOVI(SAHITI) | | | | | V | V | V | |
| | | | ISUF | V | V | | | | P |
| | | | ISUF | V | | | | | P |
| | | | ISUF | V | V | | | | V |
| | | | ISUF | V | | | | | P |
| | | | ISUF | V | | | | | P |
| SAQINE | LUTAJ | | | | | | V | V | V |
| SELAM | LUTAJ | | | | | | V | V | V |
| MELEQE | PASHAJ | | | EQEREM | V | V | V | V | V |
| | | | | | | V | V | V | |
| | | | | | | V | V | V | |
| | | | | | | V | V | V | |
| EQEREM | LUTAJ | | | | | | V | V | V |
| | | | | | | EQEREM | V | V | |
| | | | | | | EQEREM | V | V | |
| | | | | | | EQEREM | V | V | |
| HAMIDE | SALAJ | | | | | V | | | |
| | | | | | | | | | |
| VJOLLCA | TARKA | | | | | V | V | | |
| | | | | | | | V | V | V |
| GJEKE | MIKAJ | | | | | | V | V | V |
| | | | | | | GJEKE | | | |
| | | | | | | GJEKE | | | |

(Vijon nesër)

Fjalëkryqi (1)



- 41. Kush ka... ka zët.
- 42. Mbyllin komentin.
- 43. I bëhen të gjitha mikut.
- 45. Një version i dikurshëm i FIAT.
- 46. Fillojnë shkurt.
- 47. Një pikë në ligj.
- 48. Inicialet e Morricono-s.
- 49. Të fundit në manastir.
- 50. I ka kërcyer të xhindosurit.
- 51. Janë pjesë të dramës

- VERTIKAL**
- 1. Fillojnë panikun.
 - 2. Ai i trëndafilit është i Umberto Eco-s.
 - 3. Në krye të tenorëve.
 - 4. Mund të jetë gjaku dhe kuzhine.
 - 5. Inicialet e Anka këngëtar.
 - 6. Kush ka... ka nevojë për gjak
 - 7. Ndiqet ajo e fundit
 - 8. Duken të gjata në pritje.
 - 9. Një fazë gjumi.
 - 10. Shteti i francezëve
 - 12. Një art i shtatë.
 - 13. Eshë pelgu.

- HORIZONTAL**
- 1. O Toole aktor
 - 5. Si vizuale.
 - 11. Në fund të lutjes.
 - 13. Janë popullsi e dytitit
 - 14. Një pije freskuese.
 - 17. Eshë enijje.
 - 18. Teke prize.
 - 20. Janë mallkime shkishëruese.
 - 22. Një aftësi paranormale.
 - 25. Janë fakultetet më me leverdi.
 - 27. Gjëja e romakëve.
 - 29. Thahen me bonifikim.
 - 30. Zemeckis regjisor
 - 33. Janë në temë
 - 34. Inicialet e Harris aktor.
 - 36. Eshë figurë gjeometrike.
 - 37. Një markë makine qepëse.


- 15. Shkroi Pa familje
- 16. Janë dokumente shtëpie.
- 18. Eshë filmi që mallëngjen.
- 19. Një kolegji anglez.
- 21. Janë baballarët.
- 23. Mund të jetë elektrike.
- 24. Eshë hidrofobi.
- 26. Ajo e forcës është për të çmendur.
- 27. Kremi pa ekstreme.
- 28. Si sezonate.
- 31. Mund të jenë unike
- 32. Mund të jenë periode të tilla.
- 35. Eshë bishë që zgërdhiet.
- 38. Fillojnë nazet
- 39. Inicialet e Diamanti aktore.
- 40. Eshë mosha më e bukur.
- 44. Fillojnë temën.
- 46. Kufizojnë një send.

Fjalëkryqi (2)


- HORIZONTAL**
- 1. Një film publicitar
 - 5. Në krye të bashkisë .
 - 7. Me Romeo në makinë
 - 10. Në fund majtas
 - 11. Janë kompozime si Vejusha gazmore
 - 15. Janë në masë.
 - 16. Janë melodrama.
 - 17. Fillojnë dobët.
 - 18. Në hyrje të radios.
 - 19. Një pjesë e lipotimisë.
 - 21. Eshë gjendje të fikti.
 - 24. Eshë vërtet i mërzitshëm.
 - 25. Maiden që këndojnë
 - 26. Hurley aktore.
 - 27. Pak torturuese.
 - 28. Ekstreme në tunel.
 - 29. Ndezur në aparaturë.
 - 30. Ai i shenjtë është papa.
 - 31. Merrte fuqi nga toka.

- 32. Pak enigmatike.
- 33. Ngriset në mbremje.
- 35. Kufij itinerari.
- 36. Ai i harresës ishte Leti.
- 39. Eshë porosia e fundit.
- 41. Janë bimë uji.
- 42. Opera e Mascagni-t.
- 44. Magritte piktor.
- 46. Eshë ndenjësë zbukurimi.
- 48. Ndiqen me ilaçe.
- 50. Në krye të armiqve.
- 51. Një godinë në miniaturë
- 52. Eshë muzika... më e kollajtë.


- VERTIKAL**
- 1. Qe mbreti i parë i Izraelit.
 - 2. Post scriptum
 - 3. Një sferë... për model.
 - 4. Eshë infeksion në bark
 - 5. Një mund të jetë arme.
 - 6. Në krye të atletëve.
 - 7. Eshë grimcë me bërbamë.
 - 8. Ishte sundimtar si Tutankamon
 - 9. Masat pa kufij
 - 12. Një sport baskësh .
 - 13. Janë marrëdhënie.
 - 14. Padia pa kufij.
 - 16. Eshë në minorancë.
 - 20. I ka shumë të goditura Agron Llakaj.
 - 22. Kështu janë lojtarë te formaconit
 - 23. Janë të holla dhe therëse.
 - 26. Makinë ruse.
 - 32. Eshë dita e dytë
 - 34. Bisha aktore.
 - 37. Në mes të rrugës.
 - 38. Një trup pa kënde.
 - 40. Satie kompozitor.
 - 43. I ka të ndryshme një sakt.
 - 45. King Cole i muzikës.
 - 46. Inicialet e Penn aktor.
 - 47. Në mes të dhomës.
 - 49. Të fundit në spital.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|--|
| | | 1 | | | | 9 | 8 | 6 | |
| 5 | | | 1 | 4 | | | 9 | | |
| 4 | | 8 | 2 | | | | | 7 | |
| | | | | 7 | 2 | 3 | 8 | 6 | |
| | | | 9 | | | | 5 | | |
| 2 | 3 | 6 | 4 | 8 | | | | | |
| | 8 | | | | 7 | 4 | | 9 | |
| | | 3 | | 6 | 1 | | | 7 | |
| 2 | 1 | 5 | | | | | 3 | | |

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 5 | 4 | 8 | 6 | 7 | 9 |
| 6 | 9 | 7 | 2 | 3 | 1 | 4 | 8 | 5 |
| 4 | 8 | 5 | 6 | 9 | 7 | 2 | 1 | 3 |
| 7 | 4 | 6 | 9 | 2 | 3 | 8 | 5 | 1 |
| 9 | 1 | 2 | 8 | 5 | 6 | 7 | 3 | 4 |
| 3 | 5 | 8 | 1 | 7 | 4 | 9 | 2 | 6 |
| 5 | 7 | 4 | 3 | 8 | 9 | 1 | 6 | 2 |
| 2 | 6 | 9 | 7 | 1 | 5 | 3 | 4 | 8 |
| 8 | 3 | 1 | 4 | 6 | 2 | 5 | 9 | 7 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Nuk ka rëndësi ku dhe si keni jetuar. E rëndësishme është çfarë keni bërë aty ku keni qenë. (Xhorxha O'kife)
- Era dhe dallgët janë gjithnjë në anën e detarit të zot. (Eduard Gibon)
- Eshë shumë vështirë të jeni efiçent pa qenë kundërshtues. (Kin Hubbard)
- Që njeriu të realizojë atë që i kërkohet, duhet të konsiderojë veten më të madh nga sa është. (Gëte)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|-----|----|----|----|----|----|---|----|----|----|---|----|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 15D | 1 | 7 | 2 | 3 | 1 | 4 | 2 | 17 | 6 | 2 | 4 | T | R | I | M | S | M | M | A | S | A | T | | |
| 4O | 2 | 3 | 10 | | 11 | | 17 | 4 | 9 | 3 | 2 | A | R | B | E | S | E | M | L | I | M | A | | |
| 17B | 7 | | 8 | 6 | 9 | 6 | 13 | 4 | 6 | | 17 | 7 | K | D | E | L | E | G | A | T | E | T | L | |
| 7I | 11 | 7 | 2 | 6 | 1 | 4 | 2 | | 2 | 4 | 8 | | M | I | T | O | M | A | N | E | T | D | E | |
| | 8 | 6 | 12 | 4 | 13 | 2 | 4 | 2 | | 4 | 9 | 4 | K | O | M | U | N | I | T | E | T | E | T | N |
| 18 | 3 | 1 | 4 | 12 | | 4 | 1 | 4 | | 1 | 3 | 2 | O | P | E | R | A | T | O | R | E | T | F | T |
| 2 | 5 | 12 | 2 | 3 | 12 | | 3 | | 16 | 1 | 3 | 3 | M | N | I | E | N | O | G | A | | | | |
| | 16 | 3 | | 4 | 15 | | 16 | 2 | 7 | | | 3 | P | S | N | N | I | M | A | L | L | I | | |
| 15 | 2 | 4 | 8 | 16 | 2 | | 12 | 7 | 2 | 4 | 2 | | A | M | I | A | N | T | K | I | O | S | E | |
| 4 | 18 | | 1 | 1 | 7 | | 8 | 7 | 9 | 6 | 13 | 7 | N | O | T | E | K | I | P | O | R | E | | |
| 12 | 7 | 1 | 7 | 3 | 12 | | 8 | 1 | 4 | 1 | 4 | 2 | I | T | N | E | T | I | L | E | N | I | E | |
| 7 | 2 | 3 | | 10 | 7 | 3 | | 3 | 2 | 7 | | 6 | A | L | I | B | I | S | I | R | T | A | R | I |

PËRGJIGJET E FJALËKRYEQVE TË NUMRIT TË KALUAR

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| F | A | U | T | O | P | O | R | T | R | E | T | |
| A | S | T | R | I | D | K | O | R | E | E | K | |
| R | H | T | R | I | D | C | B | E | P | M | A | |
| A | K | M | A | R | A | T | O | N | A | A | P | |
| D | O | N | A | T | O | R | E | T | R | I | T | A |
| P | I | R | A | T | O | R | E | T | E | T | C | |
| K | T | N | E | M | A | T | E | T | E | R | R | I |
| R | I | T | A | A | M | E | T | R | A | T | | |
| I | N | V | E | N | U | S | B | E | N | V | E | |
| J | O | E | R | P | E | T | A | L | E | T | | |
| I | D | A | T | I | K | A | E | M | I | L | E | |
| M | A | T | A | M | I | N | A | R | E | T | T | |



PËRGJIGJET E FJALËKRYEQVE TË NUMRIT TË KALUAR

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P | I | E | R | N | M | A | R | A | T | B | | |
| E | R | A | M | E | Z | O | N | E | M | A | | |
| R | E | M | I | R | E | L | O | M | I | R | | |
| I | N | A | K | O | L | O | N | I | T | E | I | |
| P | E | R | S | E | R | I | T | E | S | I | T | T |
| A | T | E | L | E | G | O | N | I | O | P | O | |
| T | R | E | N | T | V | A | N | E | N | T | | |
| E | M | R | A | I | Z | K | O | M | E | T | E | |
| T | I | T | M | A | N | E | T | M | A | T | | |
| I | A | O | R | N | A | T | E | I | L | | | |
| K | D | R | O | M | A | N | R | A | E | K | | |
| E | U | R | E | K | A | A | T | O | M | T | U | |

Thënie të mënçura

- Fatkeqesite tregojne kush jane shoke te vertete.
- Aristoteli (384 BC - 322 BC), Eudemian Ethics
- Mund te besh me shume miq per dy muaj nese shpreh interesim per njerezit e tjere se sa mund te besh per dy vjet duke u munduar t'i besh tjeret te interesohen per veten tende. Dale Carnegie
- Pengesa më e madhe e njeriut, janë mendimet e tij.
- Asgjë nuk e forcon autoritetin më shumë se heshtja.
- Kam vënë re se njerëzit rrallë përpiqen të arrijnë diçka. Ata më tepër rehatohen dhe i lënë gjërat t'u ndodhin. Në fakt, ata i dolën përpara rastësisë dhe u ndodhën te gjërat.

